



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2016

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të shërbimit me ujësjellës, shërbimeve të ujërave të ndotura, furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË PËR VITIN 2016

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE	5
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU	7
1 HYRJE	8
2 ZHVILLIMET NË SEKTOR	9
3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU	13
3.1 Shërbimet e ujësjellësit	13
3.2 Shërbimet për ujëra të ndotura	30
3.2.2 Performanca komerciale	31
3.3 Performanca financiare e KRU	37
3.4 Performanca e përgjithshme e KRU	40
4. PERFORMANCA E SEKTORIT	42
4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF	42
4.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe ujëra të ndotura	43
4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar	44
4.4 Investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujësjellës dhe ujëra të ndotura	45
5. PERFORMANCA E NHE 'Ibër Lepenci'	48
6. AKTIVITETET E KKK	50
7. SFIDAT PËR TË ARDHMËN	51
SHTOJCA 1 Kualiteti dhe të dhënat e detajuara të performancës	53
SHTOJCA 2 Definicionet dhe arsyeshmëria	71
SHTOJCA 3 Pasqyrat financiare sipas kontabilitetit Rregullator	78
SHTOJCA 4 Pasqyrat tarifore(2015-2017)	82
SHTOJCA 5 Përmbledhje treguesish të performancës-2016	83
SHTOJCA 6 Të dhënat statistikore-2016	84
SHTOJCA 7 Detajet kontaktuese	86
SHTOJCA 8 Zonat e shërbimit të KRU	87

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BB	Banka Botërore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
GKN	Grupi Kordinues Ndërinstitucional për Cilësinë e Ujit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
IAWD	Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive të Ujësjetësve për vendet e Danubit
KNMU	Këshilli Ndërmintor për Ujëra
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KUR	Kompania Rajonale e Ujësjetës
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
PRE	Programi për Reforma Ekonomike
PMV	Plani i Monitorimit Vjetor
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
DWP	Programi i Ujit për Danubin
DCM-P	Mbledhja e të dhënave dhe Platforma Menagjuese
ERRU	Enti Rregullator i Ujit në Shqipëri,
EWRC	Rregullatori i Ujit dhe Energjisë në Bullgari
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik në zyren e Kryeministrit
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SHUKOS	Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
WAREG	Rregullatorët Europianë të Ujit

FJALA HYRËSE



Me kënaqësi ju prezantoj Raportin vjetor të performancës për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë për vitin 2016, të njëmbëdhjetin me radhë, të cilin ARRU e përgatit në pajtim me mandatin e dhënë ligjor.

Përmes mekanizmave të dhënë me Ligjin nr. 05/I -042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, ARRU udhëheq dhe rregullon sektorin e ujit në përputhje me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara-2010, e pranuar nga institucionet vendore përmes së cilës qytetarëve ju garantohet e drejta për sasi të mjaftueshme me ujë të pastër dhe sanitacion, të përballueshëm financiarisht dhe fizikisht të mundshëm¹.

Sektori i ujit në Kosovë është sektor i shërbimeve publike dhe duke pasur parasysh se ofruesit e këtyre shërbimeve në mungesë të tregut kanë monopol në këtë sektor, ARRU përmes monitorimit dhe vlerësimit krahasues ka për synim të stimulojë efektet e konkurrencës si një mënyrë për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, duke matur punën e ofruesve të shërbimeve kundrejt njëri-tjetrit, në raport me standardet e përcaktuara, si dhe obligimeve tarifore.

Viti 2016 karakterizohet me disa zhvillime të rëndësishme në sektorin e shërbimeve të ujit në Kosovë.

Një prej sfidave të cilat e kanë përcjellur në mënyrë të vazhdueshme sektorin e shërbimeve të ujit ka qenë mungesa e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm. Përmes angazhimeve nga të gjitha palët e interesit (Qeveria e Kosovës, Komunitat, Donatorët dhe vet ofruesit e shërbimeve) në ngritjen e kapaciteteve prodhuese, kjo sfidë pothuajse është tejkaluar. Me kapacitetet prodhues shtesë prej 2000l/s në nivel të vendit krahas kapaciteteve ekzistuese, furnizimi i pandërprerë dhe i qëndrueshëm me ujë të pijes tanimë është i mundshëm.

UPF (Humbjet e ujit) vazhdon të mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor për të gjithë ofruesit e shërbimeve pa përjashtim. Edhe pse ka përmirësim gradual vit pas viti të disa ofrues të shërbimeve, humbjet e ujit në nivel vendi vazhdojnë të jenë në shkallë shumë të lartë. Për të pasur përmirësime në këtë drejtim, ofruesit e shërbimeve si përgjegjës për zvogëlimin e humbjeve, duhet ti qasen më seriozisht këtij problemi përmes menaxhimit dhe zhvillimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve. ARRU gjithmonë do t'i mbështesë ofruesit e shërbimeve me të gjitha mjetet që ka në dispozicion për të arritur këtë qëllim.

Në bazë të analizave të bëra, të pasqyruara në raportet e IKSHPK rezulton se cilësia e ujit të ofruar nga ofruesit e shërbimeve është e mirë. Niveli i përgjithshëm i testeve të kaluara tregon një përputhshmëri të lartë të kualitetit të ujit me standardet e përcaktuara. Kjo para së gjithash është rezultat i drejtpërdrejtë i angazhimit të ofruesve të shërbimeve për të ofruar ujë cilësor, por edhe reflektimi i një sistemi gjithnjë më efikas i monitorimit dhe i menaxhimit të cilësisë së ujit për pije në pajtim me standardet e përcaktuara nga IKSHPK, respektivisht nga Qendra e Ujit.

Ndër aktivitetet primare të ARRU për vitin 2016 ka qenë licencimi i ofruesve të shërbimeve, me ç'rast i janë përtrirë licencat ofruesve të shërbimeve për një periudhë të ardhme tri vjeçare. Komunitat Shtërpce, Novo Bërd, Partesh, Kllokot, Ranillug dhe Hani I Elezit janë përfshirë në kuadër të licencave të kompanive respektive dhe planifikohet të integrohen në KRU përkatëse pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre. Rehabilitimi është planifikuar të zbatohet përmes investimeve të fazës së V-të të projektit të SDC (investim i përbashkët i Qeverisë Zvicerane dhe Qeverisë së Kosovës). Marrëveshjet me komunitat përkatëse janë nënshkruar dhe integrimi do të bëhet pas pranimi teknik të punëve.

¹ Politika e Qeverisë për Ujëra version final- mars-2015, Republika e Kosovës

Viti 2016 ka shënuar vitin e dytë të periudhës së rregullt tarifore tri (3) vjeçare 2015-2017. Sikurse edhe në vitet paraprake, përmes rishikimit të tarifave, ARRU është munduar të mbajë ekuilibër për të siguruar që konsumatorët të marrin shërbime të cilësisë më të mirë të mundshme me një çmim të arsyeshëm duke pasur gjithmonë parasysh edhe qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve. Vlen të theksohet se tarifat e aprovuara nga ARRU në vitin 2016 kanë mbetur të njëjta edhe për vitin aktual (2017). Me qëllim të lehtësimit dhe stimulimit të konsumatorëve për qasje në shërbimet e ujit, përmes urdhëresës tarifore kemi korrigjuar disa nga tarifat dytësore siç është ajo për gjobot për lidhje dhe rilidhje ilegale e cila është larguar tërësisht si dhe është zbritur në nivel simbolik taksa administrative për lidhje në shërbime.

Me qëllim të marrjes së opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ofruara të ujit dhe pritjet e tyre për përmirësime, ARRU ka zhvilluar hulumtim në nivel të vendit. Nga ky hulumtim rrjedh se akoma një pjesë e konsumatorëve nuk janë të kënaqur me shërbimet e ofruara dhe konsiderojnë se çmimet janë të larta krahasuar me standardin e jetesës në Kosovë, ndërsa pritjet për përmirësim janë në trajtimin më të mirë të ankesave, përmirësimin e furnizimit të rregullt me ujë (zvogëlimin e ndërprerjeve të shumta në rrjet) etj.

Edhe gjatë vitit 2016, ARRU ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet e rëndësishme ndërkombëtare të këtij sektori siç janë: DANUBIS, WAREG, ERRU-Shqipëri, EWRC-Bullgari, etj., me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit dhe jemi anëtarësuar me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e përvojave.

Dëshiroj të falënderoj gjithë stafin e ARRU e në veçanti ata që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij raporti, si dhe menaxhmentin dhe të gjithë zyrtaret e KRU-ve për bashkëpunimin e vazhdueshëm me ARRU.

Me respekt,

Raif Preteni, Drejtor i ARRU



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) është institucion i pavaruar, llogaridhënës për punën e tij para Kuvendit të Kosovës i themeluar në vitin 2004, me përgjegjësinë për të menaxhuar një kuadër rregullator efektiv, i cili siguronë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorët.

Përgjegjësit specifike të ARRU janë:

Licencimi i ofruesve të shërbimeve, duke siguruar që ato ti kryejnë siç duhet aktivitetet dhe funksionet e tyre ligjore. Me licenca përcaktohen kushtet nën të cilat ofruesi i shërbimit do të veprojë në kuadër të zonës së tij operuese duke:

- poseduar kapacitete profesionale dhe resurse adekuate menaxhuese, operative dhe teknike për operim dhe mirëmbajtje për ofrim të shërbimeve sipas standardeve të pranueshme të shërbimit,
- pranuar përgjegjësinë për ofrim të shërbimeve në tërë zonën e shërbimit të përcaktuar me politikat dhe planet e qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve.

Përcaktimi i tarifave të shërbimit për të promovuar interesat e konsumatorëve duke vendosur çmimet për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në përputhje me objektivat e tyre me kosto të përgjithshme më të ulët të arsyeshme dhe duke:

- promovuar konkurrencën efektive,
- siguruar që ofruesit e shërbimeve të ujit të kryejnë/financojnë siç duhet funksionet e tyre statusore.

Vendosja e standardeve minimale të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve, për:

- trajtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve,
- testimin e ujit dhe kontrollin e cilësisë për t'ju garantuar konsumatorëve cilësi në përputhje me standardet kombëtare të ujit të pijshëm,
- të siguruar që ata të paguajnë me saktësi për shërbimin e ujit,
- përmirësuar besueshmërinë, nëpërmjet minimizimit dhe menaxhimit të ndërprerjeve.

Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve, është një përgjegjësi tjetër e cila ka synim motivimin e ofruesve të shërbimeve për të përmirësuar performancën dhe për të:

- siguruar, funksionimin eficient të ofruesve të shërbimeve dhe sektorit në tërësi,
- përcaktuar, nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e përcaktuara përmes procesit tarifar, kornizës ligjore si dhe standardeve ndërkombëtare të pranueshme,

Themelimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës me qëllim të:

- konsultimit të konsumatorëve dhe dhënies së rekomandimeve për Autoritetit rreth çështjeve me rëndësi, përkitazi me ofrimin e shërbimeve, si dhe
- shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga ofruesi i shërbimeve;

Inspektimi i standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit, nga ana e ofruesve të shërbimeve.

ARRU gjithashtu udhëhiqet nga parimet e praktikave më të mira rregullatore, përfshirë: transparencën, llogaridhënien, proporcionalitetin, mosdiskriminimin, konsistencën dhe synimet në përputhje me politikat strategjike të publikuara nga Qeveria e Kosovës, në aspektin zhvillimor dhe mjedisor.

1 HYRJE

Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë për vitin 2016, është një prej aktiviteteve të rëndësishme të ARRU, që ka për qëllim për të raportuar publikisht dhe në mënyrë të pavarur mbi performancën e ndërmarrjeve të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe shërbime të ujërave të ndotura. Është raporti i njëmbëdhjet me radhë në një seri të raporteve kombëtare të prodhuara nga ARRU dhe të mbështetura në kontributin e drejtpërdrejtë të KRU të cilat i janë përgjigjur kërkesave raportuese Rregullatore.

Në këtë raport krahasohet performanca e 7 kompanive rajonale të ujësjellësit të cilat ofrojnë shërbimet e tyre (furnizim me ujësjellës dhe shërbimet e ujërave të ndotura) për rreth 1.52 mil.njerëz(ujësjellës, përkatësisht 1.16 mil. milion njerëz(ujëra të ndotura) në 34 komuna të Kosovës dhe një kompanie e cila furnizon ujë të pa trajtuar me shumicë për dy KRU (Prishtina dhe Mitrovica).

‘Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm’ i referohet furnizimit me ujësjellës për të gjithë konsumatorët shtëpiak, komercial-industrial, si dhe institucional, përderisa ‘Shërbimi i ujërave të ndotura’ përfshinë mbledhjen, trajtimin e ujërave të ndotura, ndonëse trajtimi i tyre aktualisht në Kosovë është në nivel shumë të ultë.

‘Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit’ detajon informacione për trendet aktuale të punës individuale të KRU dhe sektorit në përgjithësi përfshirë: nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit, si dhe aspektet financiare, operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve. Për më tepër raporti ka për synim të:

- siguron një qasje të qëndrueshme në nivel kombëtar për të mundësuar një garë të shëndetshme midis ofruesve të shërbimeve,
- informon konsumatorët dhe institucionet përgjegjëse të përfshira në proceset vendimarrëse (Qeverinë, Rregullatorin, etj.) për nivelin e shërbimit.

Raporti është strukturuar si më poshtë:

Pjesa A - Performanca e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit, jep komentet dhe analizat për nivelin e treguesve të punës që pasqyrojnë performancën individuale të KRU. Vlerësimi i performancës bazohet në një numër treguesish kryesor të performancës, përfshirë aspektet të cilat lidhen me standardet e shërbimit, performancën teknike, financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve, ndaras për të dy shërbimet (furnizimi me ujësjellës dhe ujëra të ndotura).

Pjesa B-Performanca e Sektorit të Shërbimeve të Ujësjellësit – Ujërave të ndotura, komenton performancën e sektorit si një tërësi, duke dhënë disa të dhëna të rëndësishme dhe informacione për treguesit përfshirë: prodhimin e ujit, shitjet, humbjet e ujit, mbuleshmërinë me shërbime, qarkullimin në nivel të sektorit, si dhe investimet në total në të dy shërbimet (furnizim me ujësjellës dhe trajtim i ujërave të ndotura), për periudhën 5 vjeçare (2012-2016).

Pjesa C- Performanca e Furnizuesit të Ujit me Shumicë, ofron disa të dhëna statistikore dhe informacione për treguesit e performancës për ndërmarrjen e vetme NHE ‘Iber Lepenci’, e cila furnizon ujë të pa trajtuar me shumicë për disa nga KRU.

Pjesa D- Aktivitetet e KKK, përmban informacionet për aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në 7 regjione të Kosovës në lidhje me trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe temave të tjera të cilat janë në interesin e konsumatorëve.

Shtojcat: japin të dhëna statistikore, tabelat me të dhënat e detajuara të performancës, pasqyrat përmbledhëse rregullatore dhe tarifore, definicionet e të dhënave dhe treguesve, detajet e kontaktit dhe informacione të tjera të vlefshme.

2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

Ngritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm, një prej sfidave të cilat e kanë përcjellur në mënyrë kronike sektorin e shërbimeve të ujit ka qenë mungesa e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm, si duket tani do të jetë në tejkalim e siper, meqenëse viteve të fundit ka pasur një angazhim konkret nga të gjitha palët e interesit (Qeveria e Kosovës, Komunitat, Donatorët) përfshirë edhe konsumatorët në ngritjen e kapaciteteve prodhuese. Janë ndërtuar impiant modern për trajtimin e ujit të pijshëm, dy të tilla janë ndërtuar në zonën e shërbimit të KRU 'Mitrovica' (Balincë dhe Shipol) dhe po ashtu dy impiant për trajtimin e ujit, janë ndërtuar edhe në zonën e shërbimit të KRU 'Prishtina' (Badovc dhe Shkabaj), në KRU 'Radoniqi', është duke u ndërtuar një aneks shtesë në fabrikën e prodhimit të ujit me ç'rast kapaciteti prodhues do të dyfishohet në këtë kompani. Në përgjithësi kapacitetet prodhuese shtes aktualisht janë rreth 2000l/s. e të cilat janë një garancë se furnizimi me ujë të pijes përgjatë 24 orëve – pra furnizimi i pandërprerë tani me është i mundshëm në Kosovë.

Projektet për trajtimin e ujërave të ndotura, në përgjithësi në Kosovë nuk ka trajtim të ujërave të ndotura. Shkarkimi i tyre zakonisht bëhet direkt në lumenj dhe paraqet një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore. I vetmi impiant për trajtimin e ujërave të ndotura është në Skënderaj i menaxhuar nga KRU 'Mitrovica'. Në vitet e fundit kemi një angazhim më të madh në avancimin e përmirësimit të kushteve ambientale, ku trajtimi i ujërave të ndotura zë vend kyç.

Me përkrahje kryesisht nga donatorët e jashtëm janë kryer studime të fizibilitetit për trajtimin e ujërave, për qëndrat më të mëdha të Kosovës". Aktualisht janë në fazën e implementimit të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura në Prizren dhe Gjakovë, e pastaj në Pejë dhe Prishtinë.

Për projektin e trajtimit të ujërave të ndotura në regjionin e Prizrenit është nënshkruar marrëveshja për financimin e projektit në mes të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuna e Prizrenit. Ky projekt në vete përmban disa komponentë: ndërtimin e fabrikës së ujërave të ndotura, ndërtimin e kolektorit të ri dhe rehabilitimin e kolektorit tjetër ekzistues, si dhe investime në rehabilitimin të rrjetit të ujërave të ndotura në pikat kryesore në qytetin e Prizrenit.

Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Qeverinë Federale të Gjermanisë përmes KfW-së, Qeverinë e Konfederatës Zvicerane përmes SECO-së, Komunitetin e Pejës, si dhe Komunitetin Rajonale të Ujësjetës 'Hidrodrini' në Pejë, nënshkruan një marrëveshje për menjimin e ujërave të ndotura në Jugperëndim të Kosovës-Faza IV, respektivisht për Komunitetin e Pejës.

Në Gjakovë është duke u implementuar projekti "Eliminimi i Ujërave të Ndotura në Jug-Perëndim të Kosovës, Faza e III-të dhe V". Projekti është duke u mbështetur me fondet e Qeverisë Zvicerane dhe asaj Gjermane.

Hapat konkret kanë filluar në implementimin e projektit për trajtimin e ujërave të ndotura në regjionin e Prishtinës (Prishtinë, F. Kosovë dhe Obiliq), e cila do të mbështetet nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Francës dhe komunitet respektive.

Vlerësohet se kostoja totale për trajtimin e ujërave të ndotura është shumë e lartë, pritet janë se do të këtë një përkrahje nga agjencionet zhvillimore dhe qeveritë e vendeve mike të Kosovës. Ato sugjerojnë që sa më shumë të shmanget marrja e kredive për projektet e ujërave të ndotura, mëqë konsiderojnë se sektori (në veçanti kompanitë rajonale të ujit dhe konsumatorët) ende nuk janë të gatshëm të mbajnë kostot e kredive të tilla.

Paralelisht me angazhimin gjithnjë në rritje për ndërtimin e ITUN, ka një interes të shtuar nga të gjitha palët e interesit përfshirë ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorët për vendosjen e politikave të drejta tarifore, të cilat do të jenë të përballueshme dhe të krijojnë qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve, gjithnjë duke marrë parasysh parimin e njohur për mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë "Ndotësi duhet të paguaj".

Me kërkesën e ARRU është bërë një studim i fizibilitetit i përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim- SDC RWSSP V për shqyrtimin e politikës ekzistuese të tarifës uniforme për shërbimet e ujërave të

ndotura e cila aktualisht është duke u zbatuar nga ARRU. Raporti i fizibilitetit ka konstatuar se ekziston një pajtim i përgjithshëm dhe qasja ekzistuese e tarifës uniforme, në përputhje me Politikën e Ujërave të Kosovës dhe me 'Politikën Tarifore për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim', gëzon një përkrahje të gjërë nga palët e interesuara si një qasje më e përshtatshme e politikës tarifore për shërbimin e ujërave të ndotura. Raporti ka dhënë disa rekomandime të vlefshme të cilat duhet ndjekur në të ardhmën nga ARRU dhe akterët e tjerë në sektor në lidhje me këtë shërbim.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim(SKZH), është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në Janar 2016. Ky dokument strategjik zhvillimor ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës. SKZH ka integruar strategji të shumta sektoriale dhe politikat ekzistuese duke krijuar një bosht të përbashkët orientues dhe duke përzgjedhur "prioritetet më të larta të vendit". Krijimi i një liste të tillë të prioritetëve, në formën e një strategjie ombrellë, ka qëllim krijimin e sinergjive ndërmjet nismave të ndryshme, parandalimin e proceseve të dyfishta institucionale, eficiencë më të lartë të punës, orientimin e përkrahjes nga partnerët zhvillimorë, si dhe vendosjen e një boshti të fuqishëm orientues për institucionet e Kosovës dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve. Bashkëpjesmarrës të këtij dokumenti janë: institucionet shtetërore, sektori privat, shoqëria civile, partnerët zhvillimor, etj. Masat e parapara në këtë dokument kërkojnë kontributin e secilit prej tyre për të qenë të efektshëm, qoftë si zbatues apo si mbikëqyrës.

SKZH është në harmoni të plotë me proceset e tjera strategjike, me procesin e integritetit në BE përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) apo Programit për Reforma Ekonomike (PRE) dhe kryesisht është i sinkronizuar me prioritetet e reformave ekonomike dhe institucionale të nevojshme për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Dokumenti është përgatitur nga institucionet e Kosovës, me rolin prijës dhe koordinues të Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS), i mandatuar nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe me mbështetje teknike prej Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë

"Masa 32, Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve të burimeve ujore", nga Shtylla 4: SKZH-së është një plan për infrastrukturën përfshirë, resurset dhe shërbimet e ujit dhe ka paraparë përkrahjen në shtatë (7) aktivitete. MMPH është përcaktuar institucion përgjegjës, përderisa MZHE, ARRU, etj. janë në mbështetje të kësaj mase për sektorin e shërbimeve të ujit. Ky sektor ka shumë sfida të cilat duhet adresuar por probleme kryesore ende mbeten: humbjet në rrjet, aftësia e KRU për t'i mbledhur të ardhurat nga shitja dhe si rrjedhojë pamundësia financiare e tyre për të investuar në përmirësimin e rrjetit apo zgjerimin e tij.

Aktivitetet konkrete të masës 32 në sektorin e shërbimeve të ujit janë:

- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të kompanive rajonale të furnizimit me ujësjellës,
- Vendosja e ujëmatësve në të gjitha zonat e shërbimit me ujësjellës,
- Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat e shërbimit të disa KRU.

Kompanitë kanë përcaktuar dhe dërguar planet dhe vlerat e projeksioneve vit pas viti (2017-2021), në nënaktivitetet e parapara gjatë zbatimit SKZH, pra,

- Investimet në rrjetin eksiztues të ujësjellësit,
- Vendosja e ujëmatësve individual të konsumatorët ,
- Renovimi dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe
- objektivat e pritshme përgjatë kësaj periudhe projektuese në secilin prej aktiviteteve.

Përmes zbatimit të kësaj mase do të rritet shkalla e eficiencës në përdorimin e ujit, në veçanti do të mundësohet rritja e të ardhurave për kompanitë e ujit, ulja e nivelit të humbjeve, rritja e normës së lidhjeve në rrjet dhe zgjerimi i mbulimit nga rrjeti i ujitjes. Përmirësimi i furnizimit me ujësjellës do të shërbejë si mbështetës për zhvillimin e bizneseve dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Bashkëpunimi me Institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, ka vazhduar edhe më tej si me: IAWD (Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive të Ujësllësve në Zonën Ujëmbledhëse të Lumit Danub) dhe projektin aktual, respektivisht me Programin e Ujit për Danubin(DWP), i cili është në përkrahje të shoqatës, tani aktualisht faza e II (2015 – 2018), si dhe WAREG (Rregullatorët Europianë të Ujit)

Kosova është anëtare e IAWD-ës, krahas 12 shteteve të rajonit të Danubit, (Austria, Shqipëria, Ukraina, Rumania, Moldavia, Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Kosova, Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi). IAWD përmes përkrahjes së DWP, ka për synim të ju ndihmojë vendeve anëtare në ndërtimin e shërbimeve të forta dhe të qëndrueshme të ujësllësit dhe shërbimeve të ujërave të ndotura. ARRU, krahas akterëve tjerë të shërbimeve të ujit nga Kosova, ka qenë pjesë aktive e të gjitha ngjarjeve të organizuara prej saj, (konferenca, takime të grupeve drejtuese, trajnime) me pjesëmarrjen e zyrtarëve përgjegjës nga institucionet e sektorit. Nën mbështetjen e programit po ashtu është zhvilluar edhe Platforma e DANUBISIT, si një Web faqe e përbashkët e të gjitha vendeve të regjionit të Danubit. Çdo vend anëtar e ka edhe portalin e vet. ARRU ka menaxhuar dhe përditësuar të dhëna dhe informacione portalit të Kosovës si një instrument i vlefshëm në aspektin e përgjithshëm të shërbimeve, e veçanërisht për bashkëpunimin regjional në fushën e Bechmarkingut.

Programi gjithashtu ka zhvilluar një Data Bazë për raportim On-line, të quajtur Data Collection and Management –Platformë (DCM). Në këtë kontekst ARRU, si institucion menaxhues për mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e platformës të performancës së kompanive të Ujësllësve (DCM-Platforma) dhe IAWD kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit për zbatimin e saj.

WAREG – është grup i rregullatorëve ekonomik të cilët janë bashkuar për të mësuar nga përvoja e njëri tjetrit dhe për të mbështetur zhvillimet e rregullimeve ekonomike të sektorit të ujit në Evropë.

WAREG është themeluar me 23 Prill 2014 në Milano (Itali) me qëllimin primar të harmonizimit të praktikave dhe principeve të sektorit të ujit në Evropë, mbrojtjen e burimeve të ujit etj. Duke ditur se rregullatorët e ujit në Evropë kanë rol kyç në ruajtjen dhe efikasitetin e këtij sektori, pa marrë parasysh ndryshimet e kornizave ligjore të veprimtari të rregullatorëve në shtete të ndryshme, rregullatorët e ujit e kanë parë të nevojshëm themelimin e një instrumenti me qëllim të bashkëpunimit në sektorin EUROPIAN të ujit.

Për të kaluar nga një grupim i rregullatorëve në një trup legal, WAREG ka përpiluar “rregulloren e brendshme” dhe “statusin e WAREG” me qëllim të regjistrimit të WAREG-ut si shoqatë jofitimprurëse e cila së shpejti pritët të regjistrohet në Itali. ARRU ka marrë pjesë në përpilimin e këtyre dokumenteve, si dhe në raportimin e kërkuar nga grupet punuese të WAREG-ut. ARRU ka qenë nga themelimi pjesë e këtij grupi në rolin e vëzhguesit.

Duke parë zhvillimet pozitive të këtij grupi siç janë: hapat në përpilimin e statusit për tu shndërruar në shoqatë të rregullatorëve me qëllim të ndikimit në politikat e Bashkimit Evropian lidhur me harmonizimin e Ligjeve dhe Direktivave të BE, me dhënien e opinioneve për orientimin e investimeve kapitale të fondeve të BE , si dhe interesin në shkëmbim të përvojave dhe mundësive më të lehta të bashkëpunimit me rregullatorët Evropian, ARRU ka paraqitur kërkesën për tu pranuar si anëtar i përhershëm i këtij grupi.

Në takimin e fundit të Asamblesë së WAREG –ut, me dt. 20 Qershor 2017 ARRU është pranuar si anëtare e përhershme e këtij grupi. Sot WAREG ka 27 anëtarë (24 anëtarë me të drejta të plota dhe 3 anëtarë me status vëzhguesi)

PJESA A

PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT DHE UJËRAVE TË NDOTURA

3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të performancës i bazuar në një grup të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm të treguesve të performancës është një mjet i dobishëm për të ndihmuar rregullimin. Kjo i lejon Autoritetit të menaxhojë më mirë zhvillimin e sektorit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, duke ju ndihmuar ofruesve të shërbimeve që të ofrojnë shërbime më cilësore dhe duke adresuar sfidat me prioritet.

Performanca e KRU matet në 3 kategori të ndara: teknike, komerciale dhe performanca financiare gjatë vitit me informacion më të detajuar mbi trendët e zhvillimit, në më shumë të dhëna dhe tregues në menyrë të veçantë për dy shërbimet (shërbimet e ujësjellësit dhe shërbime të ujërave të ndotura).

3.1 Shërbimet e ujësjellësit

Performanca e shërbimeve të ujësjellësit është vlerësuar në aspektin e performancës teknike (standardeve të shërbimit, UPF, shërbyeshmërisë së gypave), performancës komerciale (mbulueshmëria me shërbime, matja e ujit, shitjeve sasiore të ujit dhe ankesave), si dhe performancës financiare dhe kostove (vlera e shitjeve të furnizimit, kostot njësi dhe shpenzimet kapitale).

3.1.1 Performanca Teknike

Cilësia e ujit

Cilësia e ujit i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike, në raport me një sërë standardesh kundër të cilave mund të vlerësohet pajtueshmëria. Cilësia e ujit të pijshëm, është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion adekuat e cila është prezantuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe i cili është në përputhje me direktivën e BE- së, për ujin e pijshëm. Përderisa KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHPK-QU, është Institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin ekstern, i cili siguron se uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore të cilësisë së ujit. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.




Fig.1, Kualiteti i Ujit- 2016

Në fig.1, mund të gjeni një pasqyrë mbi cilësinë e ujit të pijshëm në rubinetin e konsumit në pikat e shpërndarjes të ujit të pijshëm për vitin 2016, si dhe trendi në raport me vitin 2015.

Kanë qenë rreth 7612 mostra të marrura dhe testuara nga laboratorët testues në IKSHPK në 2016, prej të cilave 5534 mostra janë testuar në aspektin mikrobiologjik ndërsa 2078 në aspektin fiziko –kimik. Nga ky kontroll i ujit të pijshëm i bërë në pikat e shpërndarjes zbulohet se në vitin 2016 në nivel të përgjithshëm 98.0% e testeve kanë qenë në përputhshmëri me standardet vendore të cilësisë së ujit. Në aspektin bakteriologjik 98.8% në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërsa 95.9% në përputhshmëri me vlerat parametrike fiziko-kimike. Krahësuar me vitin 2015 cilësia e ujit është përmirësuar në aspektin e përgjithshëm për (1%) dhe mikrobiologjia (2.5%- ka përmirësim në bakteriet coliforme dhe E-coli). Përputhshmëria e kualitetit të ujit në aspektin fiziko-kimik është më e dobët për 1.4% se sa ishte në vitin 2015. Kryesisht ka qenë mungesa e klorit brenda vlerave të lejuara ajo e cila ka ndikuar në performancën fiziko –kimike të cilësisë së ujit.

Tabela 1, Norma(%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU

Kompanitë	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU- Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Mesataret në nivel sektori
Vitet	2016	2016	2016	2016	2016	2016	2016	
Mikrobiologjike	99.3%	98.5%	98.9%	98.6%	99.7%	98.6%	96.7%	98.8%
Fiziko - Kimik	92.5%	94.0%	94.3%	100%	100%	96.7%	100%	95.9%
Mesatare per KRU	97.8%	97.2%	97.6%	98.9%	99.8%	98.1%	97.7%	98.0%

KRU 'Radoniqi', me normën 99.8% të përputhshmërisë ka cilësinë më të mirë të ujit si në aspektin mikrobiologjik ashtu edhe në atë fiziko-kimik. Cilësia më e ulët është në KRU 'Hidromorava' 96,7%.

Në aspektin fiziko-kimik rezultate më të ulëta janë shënuar në KRU 'Prishtina' me 92.5% KRU 'Hidrodrini' me 94.0%. dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' (94.3%). Problemet kryesisht kanë qenë në efikasitetin e trajtimit me klorin rezidual që ka ndikuar në shkallën e përputhshmërisë me parametrat kimik.

Në përgjithësi cilësia e ujit e furnizuar nga KRU është e mirë dhe brenda normave të lejuara të organizatave ndërkombëtare (BE-OBSH).

Presioni i Ujit

Presioni është forca që shtyn ujin në rrjetin shpërndarës të ujësjellësit dhe është një prej standardeve të cilat përveç tjerash ndikon edhe në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimin e ofruar. Është përgjegjësi e ofruesit të shërbimeve për të siguruar një presion adekuat për konsumatorët e tij. Standardet zyrtare për presionin e ujit janë të përcaktuara me kornizën ligjore² të shërbimeve të ujësjellësit. Në Fig.2, është paraqitur norma e mesatare e pronave të shërbyera gjatë periudhës raportuese të ndodhura në zonat që në mënyrë të rregullt (kronike) ballafaqohen me presion më të ulët se niveli minimal i presionit dhe nuk përfshinë periudhat e pashmangshme afatshkurtra (mungesë e presioneve mëngjes ose në mbrëmje të hershme) ku konsumi i ujit është më i lartë, apo në periudha të thata-sezona e verës, kur njerëzit përdorin ujin e ujësjellësit për të ujitur kopshtet e tyre.

² Në kushtet e zakonshme të përdorimit të ujit, presioni hidraulik në gypin e lidhjes së konsumatorit duhet të jetë jo më pak se një e gjysëm (1.5) bar dhe jo më shumë se shtatë (7) bar. - http://www.arru-rks.org/Legislation/Rregulloria_02_2016_Shq.pdf, Rregullore për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë




Fig. 2, % e pronave me presion të ulët

Në bazë të raportimeve shifet se KRU nuk kanë shumë probleme me sigurimin e presionit adekuat të ujit. Në mesatare për vitin 2016, nga shtatë KRU janë raportuar gjithsejtë 128 prona të cilat janë ndikuar nga presioni i ulët, kjo vlerë shumë më e vogël se sa në vitin 2015, ku kanë qenë të raportuara rreth 4430 prona për të cilat nuk është siguruar një presion minimal në gypin e furnizimit të ujësjellësit.

Përveq KRU 'Prishtina' me 118 prona dhe KRU 'Hidromorava' 10, kompanitë e tjera nuk kanë raportuar prona të ndikuara nga shtypja e ulët në vitin 2016.

Në të shumtën e rasteve problemi i mungesës së presionit është i natyrës teknike përfshirë, objektet joadekuate të pompimit, apo dimensione më të vogla në gypat e rrjetit të ujësjellësit.

KRU nuk menaxhojnë me ndonjë program adekuat për matjen dhe testimin e presioneve në rrjet. Reagimet e kompanive janë ad-hok në përgjigje të ndonjë kërkesë apo ankese të konsumatorëve, apo edhe në disa raste matjeve të vendosura në pilot zonat e menaxhimit të humbjeve të ujit.

Këtë tregues edhe këtë vit duhet marrë me rezerva, meqenëse ka vështirësi në përditësimin e të dhënave nga KRU. Rregullatori ka caktuar besueshmëri relativisht të ulët, meqenëse informacionet nuk ruhen në ndonjë sistem të integruar të menaxhimit të rrjetit dhe nuk bazohen në një sistem të qëndrueshëm të testimit të presioneve.

Në këtë drejtim është me rëndësi që KRU të zhvillojnë një sistem (program) të menaxhimit të presioneve, si mënyrë më efektive dhe me kosto të arsyeshme pasi kjo ndihmon në krijimin e një sistemi 'të qetë' me frekuenca më të ulëta të shpërthimit dhe zgjatjen e jetës së aseteve në disa raste, duke siguruar një standard konsistent të shërbimit për konsumatorët gjatë ditës. Vetëm në këtë mënyrë kompanitë do të jenë në gjendje për t'u marrë me presion të dobët në mënyrë efektive dhe si bazë për mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e infrastrukturës në mënyrë adekuate.

Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës

Është një tregues standard i performancës (cilësisë së shërbimit) dhe pasqyron normën e konsumatorëve të cilët i janë nënshtruar reduktimeve të ujit. Ky tregues ka të bëjë me ndërprerjet e planifikuara të ujit (mungesa e kapaciteteve furnizuese) në këtë rast përjashtohen rastet e veçanta apo ndërprerjet ad-hok për perioda të shkurtra për shkaqe teknike apo të planifikuara.

Rëndësia e këtij treguesi qëndron tek matja e performancës së sistemit dhe mundësisë së tij për të përmbushur kërkesat e dizajnuara dhe mund të përdoret si bazë për dizajnim të sistemit dhe kërkesave të rrjetit.




Fig. 3. % e konsumatorëve me furnizim me ujë të pijshëm

Në Fig. 3, është pasqyruar norma e konsumatorëve të shërbyer në periudhën raportuese të ndarë në tri kategori, konsumatorë (prona) që kanë furnizim të vazhdueshëm me ujë për 24 orë shërbim në ditë, 18-23 orë shërbim në ditë dhe ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Vazhdimësia e furnizimit në nivel sektori ka shënuar përmirësim, norma e konsumatorëve të nënshtruar reduktimeve të ujit në vitin 2016 është ulur në 28% nga totali i përgjithshëm i konsumatorëve të shërbyer.

Orët mesatare të furnizimit me shërbime të ujësjellësit në ditë nga KRU në nivel sektori kanë shënuar një rritje nga 22.00 në 2015 në 23.00 orë në 2016.

Situata me vazhdimësinë e furnizimit me ujësjellës nën mesataren e sektorit mbetet në KRU 'Prishtina', ndonëse me kapacitetet ekzistuese ka pasur përmirësim të konsiderueshëm. Numri i konsumatorëve me furnizim të rregulltë (24h) nga kjo kompani është trefishuar në 2016/2015. Megjithatë ende mbeten probleme të theksuara në komunat: Prishtinë dhe Fushë Kosovë të furnizuara nga kjo kompani.

KRU të cilat kanë raportuar se furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU 'Radoniqi', 'Hidrodrini' por edhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Mitrovica', (ka ende pak probleme të raportuara në komunën e Vushtrisë), janë afër sigurimit të furnizimit të rregulltë me ujë për konsumatorët e tyre.

Kryesisht ka qenë mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme prodhuese (KRU Prishtina), si dhe norma e lartë e humbjeve të ujit, dy faktorët kyç, të cilët kanë ndikuar që vazhdimësia e furnizimit të jetë jo e plotë.

Në dy vitet e fundit ka pasur investime të konsiderueshme në ngritjen e kapaciteteve prodhuese për ujë të pijshëm, investime domethënëse nga institucionet përgjegjëse vendore dhe ofruesit e shërbimeve, të përkrahura edhe nga donatorët ndërkombëtar. Në zonën e shërbimit të KRU 'Mitrovica' tani më janë ndërtuar dhe lëshuar në përdorim dy fabrika moderne të ujit, një në Mitrovicë (Shipol) dhe tjetra në Komunën e Vushtrisë (Balincë). Po ashtu dy impiantet për trajtimin e ujit janë ndërtuar edhe në zonën e shërbimit të KRU 'Prishtina' (Badovc dhe

Shkabaj). Në KRU 'Radoniq' është duke u ndërtuar një aneks shtesë në fabrikën e prodhimit të ujit, me ç'rast kapaciteti prodhues do të dyfishohet edhe në këtë kompani.

Në përgjithësi kapacitetet prodhuese shtesë aktualisht janë rreth 2000l/s, të cilat së bashku me ato egzistuese do të garantojnë një furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm në të ardhmën e afërt.

Plasaritjet e Gypave

Ky tregues raporton numrin e përgjithshëm të shpërthimeve dhe rrjedhjeve në të gjithë rrjetin e shpërndarjes së sistemit të ujësjellësit dhe po ashtu jep informacione të vlefshme për gjendjen e rrjetit dhe rrjedhjeve fizike të humbjeve të ujit.




Fig. 4. Plasaritjet e gypave të ujësjellësit

Gjetjet kryesore të defekteve (plasjeve) në gypat kryesor të raportuara për 100 km të rrjetit të ujit, brenda periudhës raportuese vjetore, janë paraqitur në Fig.4. Ekziston një dallim i madhë në mes të KRU në lidhje me frekuencën e plasjes së gypave, përdorisa KRU 'Hidroregjioni Jugor' ka raportuar në mesatare 462 plasje në 100 km gyp, KRU 'Prishtina' ka raportuar 75 plasje /100 km. Mesatarja kombëtare është 215 plasje /100 km dhe gjendja është përqësuar për 19 plasje /100 km në raport me vitin 2015.

Pesë prej ndërmarrjeve kanë raportuar rritje të numrit të plasjeve në gypat kryesorë të ujit për 100 km të gypit kryesor të ujësjellësit në 2016/2015.

Trend në rënie në plasjen e gypave për 100 km kanë raportuar KRU 'Hidromorava' (172) dhe KRU 'Prishtina'(75).

Ka qënë prodhimi më i lartë i ujit (presioni) këtë vit ai i cili ka ndikuar në rritjen e numrit të defekteve, por padyshim se edhe faktorët e tjerë si vjetërsia dhe materiali i gypave kanë ndikimin e tyre. Kjo normë e papranueshme e lartë e plasjeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të humbjeve fizike, pengesa në furnizim të rregullt, si dhe në cilësinë e ujit.

Përmasa e rehabilitimit të rrjetit të ujit është e ulët në shumicën e KRU për shkak të kufizimeve financiare. Ato duhet të gjejnë dhe orientojnë investimet në drejtim të mirëmbajtjes dhe ripërtëritjes së rrjetit të furnizimit me ujësjellës, gjegjësisht në përmirësimin e performancës së rrjetit të gypave të furnizimit me ujësjellës.

Uji i pa-faturuar

Paraqet diferencën e përgjithshme, në mes të ujit të prodhuar dhe ujit i cili ka mundur të ju faturohet konsumatorëve. Në këtë seksion, UPF vlerësohet në tri aspekte, si përqindje e ujit të prodhuar në raport me shitjet (faturimin), litër për konsumatorë në ditë dhe si vlerë sasiore. Vlerësimi i UPF në këto aspekte jep një

pasqyrë të qartë për të orientuar angazhimin në drejtim të reduktimit të humbjeve të ujit. Rezultatet e llogaritjes së treguesve janë paraqitur në figurat 5,6,7 dhe në tabelën numër 2.

UPF si Përqindja e Prodhimit të Ujit

Niveli i ujit të pa-faturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët, shprehur në përqindje gjatë vitit 2016 është 57%, kjo është me e përqësuar për 1 %, në raport me vitin 2015.

KRU 'Radoniqi', 'Hidroregjioni Jugor', si dhe 'Hidrodriini' kanë arritur përmirësim në reduktimin e UPF, përderisa përmirësim më i ndjeshëm është parë në KRU 'Hidromorava'.

Tek KRU 'Prishtina' (2%), 'Mitrovica' (2%), por edhe 'Bifurkacioni', përjetuan përqësime në UPF gjatë vitit 2016/2015. Kjo rënie i atribuohet rritjes së prodhimit të ujit, si dhe mungesës së rritjes së efikasitetit të faturimit.

Një nivel standard i pranueshëm ndërkombëtarisht për UPF si përqindje e prodhimit të ujit është 25%, ndërsa të gjitha KRU pa përjashtim janë larg këtij standardi.




Fig.5, UPF- %

UPF si vlerë sasiore

ARRU ka përcaktuar nivelet e performancës për çdo KRU duke synuar mbrojtjen e interesit të konsumatorëve, të zvogëlojë shpenzimet e operimit, të rris të hyrat, të ruaj resurset e ujit. Objektiva e përgjithshme e reduktimit të UPF si vlerë sasiore për vitin 2016, përmes procesit tarifar ka qenë në nivelin 71.6.mil. m3. Kjo objektivë nuk është arritur meqenëse UPF aktualisht është rreth 81.7 mil.m3. Përveq KRU 'Radoniqi' dhe 'Hidroregjioni Jugor', asnjë nga KRU edhe në mënyrë individuale nuk kanë arritur ti përmbushin caqet në reduktimin e UPF.




Fig. 6, Vëllimi i UPF(m³/vit)

UPF në litër për konsumatorë në ditë, vlerëson humbjen e ujit në ditë në raport me numrin e konsumatorëve.

Në Fig.7 është dhënë një paraqitje grafike e UPF (litër /konsumatorë/ditë) për dy vitet e periudhes raportuese 2015-2016 në nivel sektori dhe për secilën KRU.

Në përgjithësi, UPF në litër për konsumatorë në ditë ka shënuar rënie nga 830 (litër /konsumatorë/ditë) të raportuara në vitin 2015 në 785 (litër /konsumatorë/ditë) në vitin 2016.

Gjatë 2016, shumica më e ulët e UPF (litër /konsumatorë/ditë) midis KRU është arritur në KRU 'Bifurkacioni' (464) dhe 'Hidromorava' (500). Në anën tjetër, KRU 'Mitrovica' (1635) dhe 'Hidrodrini' (1026) kanë regjistruar sasinë më të lartë të UPF (litër /konsumatorë/ditë).




Fig. 7, UPF, Liter për konsumatorë në ditë

Gjendja jo e mirë e rrjetit të ujësjellësit dhe mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit dhe ujëmatësave, lidhjet e paligjshme, si dhe një sasi e konsiderueshme e konsumit të autorizuar (kroje publike, zjarrfikësit, objektet e kultit) po ndikojnë në nivelin e lartë të UPF në KRU, por edhe në nivel të përgjithshëm të vendit.

Një nivel i tillë i papranueshëm i UPF në të gjitha KRU, ka rrit koston e operimit dhe kostot kapitale me pak të hyra për kompanitë dhe ka rezultuar me tarifa më të larta për konsumatorët, pra është e dëmshme për qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve të ujit, si dhe me ndikim negativ mjedisor. Uji i pafaturuar duhet të

përmirësohet nga të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe humbjet e ujit brenda rrjetit (humbjet fizike) duhet të reduktohen.

Përmes Programit Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale "RWSSP Faza e V-të, programi i financuar nga Agjencioni për Zhvillim Zviceran dhe Qeveria e Kosovës, përgjatë vitit 2016 kanë përfituar 4 KRU (Mitrovica, Hidromorava, Radoniqi dhe Bifurkacioni), në menaxhimin dhe reduktimin e UPF.

Këto çështje kanë nevojë për fokus të veçantë pasi që çdo përmirësim i vogël mund të çojë në efekte të rëndësishme pozitive në ofrimin e shërbimeve.

Kompanitë duhet të kenë një qasje më proaktive dhe strategjike për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit. Qeveria e Kosovës (KNMU) ka hartuar një dokument: Korniza Strategjike për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit, si Udhërrëfyes, i cili do të ju shërbente KRU për adresimin strategjik të problemit të humbjeve të ujit.

Një çështje me rëndësi është pajisja e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës funksional dhe të mirëmbajtur. Kur nuk ka matje të konsumit, konsumatorët paguajnë një tarifë fikse dhe nuk ka lidhje midis çmimeve që konsumatorët paguajnë për ujin dhe vëllimin që konsumojnë. Pa matje të plotë të ujit të prodhuar dhe faturuar konsumatorëve, përpjekjet e ndërmarrjeve për të gjurmuar UPF dhe minimizuar humbjet janë të komprometuara. Ne i nxisim KRU të përmirësojnë sistemet e tyre të matjes dhe menaxhimit të të dhënave, meqenëse ne kemi pasur dhe adresuar shqetësime evidente në besueshmërinë e tyre.

Tabela 2, vlera e UPF

KRU	UPF(%)	UPF (litër/ konsumator/ditë)	UPF (m3)
KRU Prishtina	53%	620 (l/kons./d)	23.6mil.m3
KRU Hidroregjioni Jugor	58%	630 (l/kons./d)	15.7mil.m3
KRU Hidrodrini	65%	1026(l/kons./d)	10.0mil.m3
KRU Radoniqi	47%	590(l/kons./d)	7.2mil.m3
KRU Mitrovica	62%	1635 (l/kons./d)	16.5mil.m3
KRU Bifurkacioni	52%	464(l/kons./d)	3.8mil.m3
KRU Hidromorava	57%	500(l/kons./d)	4.7mil.m3

3.1.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujësjellës, definohet si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit me qasje në shërbime të sigurta dhe të besueshme të furnizimit me ujësjellës nëpërmjet lidhjeve në rrjetin publik të furnizimit. Vlerësimi i mbulueshmërisë me shërbime, ka marrë për bazë të dhënat nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011, për ekonomitë familjare të rregulluara për një normë rritjeje vit pas viti në raport me numrin aktual të faturave të raportuara nga KRU, për kategorinë e konsumatorëve të amvisërisë.




Fig. 8, % e popullsisë në zonën e shërbimit të furnizimit me ujësjellës

Siç tregohet në Fig. 8, mbulimi me shërbime të ujësjellësit mesatarisht për shtatë KRU në 2016, është 91%. Kjo është për 4% më e lartë se sa në vitin paraprak.

Pa përjashtim, në të gjitha zonat e shërbimit të KRU, ka rritje të qasjes së popullatës në shërbime të ujësjellësit.

Përderisa në zonën e shërbimit të KRU 'Mitrovica', 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Hidromorava', ka një numër më të ulët të lidhjeve të ujit dhe dukshëm, nën mesataren e sektorit, KRU 'Prishtina', 'Radoniqi' dhe 'Hidrodrini' kanë normë të lartë të mbulueshmërisë me furnizim me ujësjellës.

KRU 'Prishtina' ka mbulueshmërinë më të lartë me shërbimet e ujësjellësit e cila ofronë shërbime edhe për një numër të qytetarëve të cilët marrin shërbime nga kjo kompani, por janë banorë të komunave tjera jashtë zonës së shërbimit të saj.

Shkallën e mbulueshmërisë më të ulët dhe atë dukshëm nën mesataren e sektorit me shërbimet e ujësjellësit, vazhdojnë ta kenë KRU 'Mitrovica', 'Hidroregjioni Jugor', 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni'.

Në bazë të projeksioneve të parapara nga kompanitë, rregulatori ka aprovuar një rritje totale të numrit të konsumatorëve prej 14,240 nga të gjitha kompanitë për vitin 2016. Kjo objektivë është përmbushur si në nivel të përgjithshëm ashtu edhe në shumicën e kompanive. Aktualisht numri i përgjithshëm i lidhjeve është mbi 327,286 dhe paraqet një rritje në bazën e konsumatorëve për 21,431, në raport me vitin 2015.

Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një element thelbësor i efikasitetit dhe menaxhimit të sistemit. Matja e ujit është një kërkesë për faturim të saktë të konsumit të ujit nga ana e konsumatorëve, si dhe mjet i domosdoshëm për kontrollin e humbjeve të ujit. Për më tepër është edhe kërkesë ligjore. Proporcioni i konsumatorëve me

ujëmatës, paraqet normën e konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve të shërbyer.




Fig. 9, % e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Raporti mesatar i proporcioneve të konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës mbetet në nivel të njëjtë në dy vitet e fundit, me 92%.

Norma e matjes tek konsumatorët komercial-industrial në vitin 2016 është në nivelin 96%, përderisa uji i shfrytëzuar nga institucionet matet në nivelin 98%.

KRU 'Mitrovica', ende ka një nivel të ulët të matjes së ujit me vetëm 64%, dhe raporti i matjes është përkeqësuar për 1% nga viti 2015 (nga 65% në 64%). Përmirësimi vit pas viti tek kjo kompani është shumë gradual. Kjo kompani duhet përsheptuar aktivitetet për vendosjen e ujëmatësave për konsumatorët e tyre edhe për faktin se mbetet shumë largë nga kompanitë tjera. Katër prej KRU 'Prishtina' me 97%, 'Radoniqi' me 97%, 'Hidrodrini' 95% dhe 'Hidroregjioni Jugor' 94%, kanë nivel të lartë të ujëmatjes edhe pse kanë ende hapsirë për të bërë deri tek ujëmatja e plotë.

Raporti i matjes është i lidhur ngushtë me menaxhimin e humbjeve të ujit, si dhe në efikasitetin e faturimit dhe arkëtimit. Pa matjen 100% të ujit të konsumuar, shifra e UPF, nuk mund të jetë e saktë dhe shpesh kanë prirje të jenë të nënvlerësuara. Matja e konsumit të ujit ndikon po ashtu në drejtim të racionalizimit të përdorimit të ujit, si dhe ofron një faturim të drejtë për konsumatorët.

Përderisa mbulimi me ujëmatës gradualisht është duke u përmirësuar, një pjesë e konsiderueshme e ujëmatësave të instaluar nuk mirëmbahen dhe janë jo funksional dhe japin lexim të pasaktë. Kjo është më e shprehur tek KRU të cilat kanë në aplikim reduktimet e furnizimit me ujë. Një furnizim me ndërprerë të ujit ndikon në funksionimin e mirë të ujëmatësave. Aktualisht KRU kanë pak kapacitet për testimin dhe kalibrimin e ujëmatësave, vetëm një laborator me kapacitet të kufizuar në kuadër të KRU 'Hidroregjioni Jugor', është i licencuar nga Agjencioni i Meteorologjisë së Kosovës (AMK), për të bërë testimin e ujëmatësave të ujit. Një laborator tjetër modern është i instaluar po ashtu në KRU 'Prishtina'.

Në mënyrë që të sigurojë se uji i konsumuar është llogaritur me saktësi, ujëmatësit duhet të jenë të zgjedhur, të instalohen dhe mirëmbahen duke përdorur standardet përgjithësisht të pranuar të industrisë. Ato duhet të testohen dhe kalibrohen rregullisht në përputhje me rekomandimet e prodhuesit dhe udhëzimet e vendosura, nga (AMK).

Ankesat

Shifrat e ankesave të konsumatorëve janë të rëndësishme dhe tregojnë nivelin e kënaqëmisë së konsumatorëve lidhur me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimit. Sipas rregullores së ARRU dhe rregullores së brendshme, KRU-të duhet të mbajnë një regjistër të ankesave të konsumatorëve dhe t'i zgjidhin sipas procedurave dhe brenda një afati kohor (standardeve të shërbimeve) të përcaktuar.




Fig. 10, Numri i ankesave në shërbimet e ujësjellësit

Numri i përgjithshëm në total i ankesave të marra nga KRU në shërbimin e furnizimit me ujësjellës përgjatë vitit 2016 ishte 14,403, që është një zbritje prej rreth 16% krahasuar me 17,153 ankesa të adresuara në vitin 2015.

KRU 'Prishtina' si kompani me numër më të madh ankesash ka raportuar në 2016/2015, zbritje të konsiderueshme të numrit të ankesave teknike (51%), përderisa numri i ankesave të natyrës komerciale është rritur (104%). Ky trend është pothuajse i njëjtë në të gjitha KRU sa i përket aspektit të ankesave komerciale, ndërsa aktiviteti i zbatimit të ligjit për faljen e borxheve ka qar në adresimin më të madh të ankesave financiare-komerciale.

Më shumë ankesa në vitin 2016 janë adresuar nga konsumatorët të cilët shërbehen nga KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Mitrovica'.

Për ndryshim nga viti i kaluar norma e ankesave për 1000 konsumatorë, në nivel të sektorit, ka rënë nga 56 në 44 ankesa për 1000 konsumatorë. Shkallën më të lartë të ankesave në proporcion me numrin e konsumatorëve e mbajnë KRU 'Prishtina', 'Mitrovica' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2016/2015, shumica e ankesave ishin të natyrës komerciale, lidhur me çështjet financiare: rreth faturimit, si dhe rreth shlyerjes së borxhit, po ashtu edhe një pjesë e konsiderueshme e ankesave ishin në lidhje me aspektet teknike të furnizimit me ujësjellës të lidhura kryesisht me standardet e shërbimit (ndërprerjet e furnizimit, matja dhe leximi i njëhsorit dhe mungesa dhe presioni i ujit).

Ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit duhet të përmirësojnë rrugët e komunikimit me konsumatorë, ankesat e tyre ti shofin në konteks pozitiv si një mjet për dëgjimin e zërit të tyre në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

Volumi i ujit të shitur

Paraqet nivelin e përmbushjes së objektivave të shitjeve sasiore të ujit në krahasim me vlerat e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara me aplikacionet tarifore të KRU.




Fig. 11, Vëllimi i ujit të shitur si përqindje e vëllimit të shitjeve të planifikuara

Edhe këtë vit vazhdon trendi i mos realizimit të shitjeve në nivelin e projektuar, ndonëse edhe objektiva nuk kanë qenë shumë sfiduese nga ana e ARRU gjithnjë duke marrë parasysh mundësitë e kompanive për të bërë përmirësime më radikale afat shkurt, ndonëse shumë të domosdoshme.

Në mesatare të sektorit përmbushja e caktuar ishte në nivelin 87%, kjo është më e lartë për 2%, në krahasim me vitin 2015, kur niveli i përmbushjes së shitjeve sasiore të ujit ishte 85%. Objektiva e përgjithshme e synuar në vlerë sasiore për 2016, ishte rreth 66.6 mil.m3 përderisa realizimi ishte rreth 57.6 mil.m3. Kjo është për 8.9 milion m3 më pak.

Edhe në aspektin individual përjashtuar KRU 'Radoniqi' asnjë nga KRU nuk i kanë arritur objektivat e shitjeve të planifikuara. KRU 'Radoniqi' ka arritur tejkalimin e objektivës për 7% në 2016. Me këtë ka zvogëluar UPF, si dhe ka rritur të hyrat e planifikuara për 2%.

Ndikimi i mos realizimit të objektivave të shitjeve sasiore nga ana e KRU, për shumicën e kompanive, ka rezultuar me të ardhura të pa mjaftueshëm financiare, si dhe rritjen e UPF.

3.1.3 Performanca Financiare³

Në këtë nën-seksion të raportit janë vlerësuar treguesit financiar përmes të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU në: faturim, kostot operative dhe kapitale, për shërbimin e furnizimit me ujësjellës.

Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale, duke krijuar vetë qëndrueshmërinë financiare.

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara, ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifar 2015-2017.




Fig.12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujësjellës në raport me shitjet e planifikuara të përcaktuara në rishikimin tarifar 2015-2017.

Edhe këtë vit sikurse edhe vitet e kaluara vlera e shitjeve në shumicën e KRU ishte më e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve (shih Figura12), dhe atë kryesisht për shkak të parashikimeve të dobëta të volumit të shitjeve, siç është paraqitur në treguesin paraprak.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2016 në nivel të sektorit për furnizim me ujësjellës ishte rreth 28 mil. euro, ndërsa ajo e planifikuar rreth 31 mil. euro, do të thotë se 90% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është më e lartë për 2% krahasuar vitin 2015 që ishte 88%.

Sa i përket performancës së shitjeve në nivel të kompanive, këtë vit KRU 'Radoniqi' prinë me përqindjen më të lartë të caktit të arritur prej 97%, duke e tejkaluar vitin paraprak 2015 për 2 %, përderisa KRU 'Hidroregioni Jugor' ka arritur vetëm 83% të arritjes së synuar njëherit me një rënie prej 1% nga viti 2015, rezultat i të cilës ka qenë niveli po thuajse i njëjtë i faturimit në euro, pa ndonjë ndryshim nga viti i kaluar, përderisa faturimi i planifikuar është rrit për 3% në vitin 2016 në raport me vitin 2015.

³ Të gjitha vlerat financiare të shprehura në euro, janë rregulluar sipas çmimeve bazë për vitin 2016, për të siguruar krahasime të duhura nga viti 2014 në vit. Viti 2014 është viti bazë i procesit tarifar (2015-2017)

Faturimi 2016 në raport me faturimin 2015




Fig.13, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujësjellës gjatë 2016 në raport me vitin 2015

Figura me lartë tregon trendet e vlerës së shitjeve të realizuara gjatë periudhës raportuese 2016 në raport me vitin 2015, nga e cila vërehet se gati të gjitha kompanitë kanë shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015, në përjashtim të KRU “Bifurkacioni”.

KRU “Mitrovica” është kompania që ka realizuar shitjet më të larta në vitin 2016 me 8.64%, në raport me vitin 2015, rezultat i të cilës ka qenë ngritja e shitjeve volumetrike për 11%.

Në vlerë absolute shitjet në nivel sektori në 2016 janë më të larta për 3.16%, si rezultat i rritjes shitjeve volumetrike për 5%.

Kostot për njësi⁴

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues i rëndësishëm financiar në bazë të cilit kuptojmë shpenzimet për një m³ të ujit të prodhuar.




Fig.14, Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2016 në raport me vitin 2015

⁴ Kostot për njësi për vitin paraprak 2015 janë të rregulluara me normë të inflacionit

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2016 nuk ka pësuar ndonjë ndryshim krahasuar me vitin 2015, ka mbetë e njëjtë me 0.045€/m³.

Kostoja e prodhimit të ujit sillet nga 0.005 €/m³ tek KRU 'Hidrodrini' në 0.082 €/m³ të KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Kostoja e lartë e ujit të prodhuar të KRU 'Hidroregjioni Jugor' edhe këtë vit është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit, në veçanti nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave (rreth 56% e shpenzimeve totale për prodhim të ujit janë nga shpenzimet e energjisë dhe derivateve).

Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujësjellës

Paraqet koston totale duke përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale për furnizim me ujësjellës në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Fig.15, Kostoja për njësi të furnizimit me ujësjellës (duke përjashtuar kthimin në Kapital dhe borxhet e këqija)

Kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës në nivel të sektorit në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 ka qenë më e ulët për 0.02 €/m³.

Siç vërehet edhe nga figura më lartë ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket koston totale për njësi për furnizimin me ujë, që nga 'Hidrodrini' i cili ka nivel të dukshëm më të ulët të koston se të gjitha kompanitë tjera të ujit me 0.25 €/m³, deri tek ajo më e lartë për KRU 'Prishtina' me 0,41 € për m³ të ujit të furnizuar.

Nëse krahasojmë koston e vitit 2016 me atë të vitit paraprak 2015 KRU 'Mitrovica', 'Prishtina' dhe KRU 'Radoniqi' kanë treguar trende pozitive në këtë tregues, me një rënie prej 0.01€ (Radoniqi), 0.03 (Prishtina) dhe 0.10 (Mitrovica), si rezultat i të cilave rënie është zvogëlimi i shpenzimeve operative për shërbimet e ujësjellës prej 3.5% të KRU 'Prishtina', pranimi i subvencionit prej 134% më i lartë krahasuar me vitin 2015 të KRU 'Mitrovica' dhe zvogëlimi i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale prej 16% të KRU 'Radoniqi' (zvogëlimi i shpenzimeve operative do të ishte më e pranueshme).

Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujësjellës e realizuar në raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujësjellës është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të cilëve edhe matet performanca e furnizimit me ujësjellës.

Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin në mes koston për njësi të furnizimit me ujësjellës të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/faturimin në m³) dhe koston për njësi të furnizimit me ujësjellës të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ faturimin në m³).




Fig.16, Kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës në raport me kostot e planifikuara për njësi

Në nivel të sektorit përmbushja e objektivave të kostove për njësi të furnizimit me ujësjellës në 2016, edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90%, por krahasuar me vitin paraprak ajo është përmirësuar për 6%, nga 116% në 110%.

Performancën më të mirë në këtë tregues e ka arritur KRU 'Mitrovica', me realizimin e kostove për njësi në nivel 87%, nivel ky i dëshiruar nga të gjitha kompanitë dhe i cili është arritur fal subvencionit që ka pranuar kjo kompani, duke i mbuluar shpenzimet operative të ujësjellësit prej 36%.

Performanca e dobët është treguar nga KRU 'Hidromorava' dhe 'Bifurkacioni'. Arsyeja e performancës së dobët qëndron tek norma e lartë e shpenzimeve operative, dhe mos realizimi i investimeve kapitale, si dhe shitjeve të ujit në vlerat e planifikuara, gjatë procesit tariforë 2015-2017 (vitin 2016).

Shpenzimet kapitale

Ky tregues pasqyron shpenzimet kapitale aktuale në shërbimin e furnizimit me ujë të ndërmarrë nga KRU, në raport me investimet kapitale të planifikuara në procesin tarifor (2015-2017), për vitin 2016.

Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujësjellësit në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2016.




Fig.17, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujësjellës në raport me ato të planifikuara

Kompanitë për vitin 2016 sikurse edhe vitet e kaluara kanë paraparë shpenzime të konsiderueshme për mirëmbajtje dhe rritje kapitale dhe atë rreth 35 mil. €. Këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Shpenzimet aktuale ishin më të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 12.5 mil. € apo 36% nga ajo që ishte planifikuar, por në realitet shpenzimet e realizuara sipas planit të biznesit për vitin 2016 ishin në nivelin prej 2% që d.m.th pjesa tjetër 34% janë jashtë planifikimit të tyre .

Vihet re se shumica e investimeve të realizuara e të deklaruara nga kompanitë kanë vazhduar të jenë kryesisht nga Grantet, (donacionet zhvillimore) përjashtuar KRU 'Hidrodrini' e cila në vitin 2016 nuk ka pranuar asnjë donacion.

Vlera e investimeve nga grantet për vitin 2016 ka qenë rreth 11.1 mil. €, ndërsa pjesa tjetër prej të hyrave vetanake.

Në nivel të sektorit për vitin 2016 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzohen rreth 4 mil. € të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, por kompanitë për vitin 2016, sipas planit, kanë realizuar vetëm 9% nga ajo që ishte e planifikuar.

Tabela 3.Vlera e investimeve në shërbimin e ujësjellësit

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujësjellësit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2016

KRU	Inv. në prodhim	Inv.në distribuim	Inv.në aktivitete biznesore	Totali
KRU Prishtina	81,787	428,731	92,903	603,421
KRU Hidroregjioni Jugor	193,539	953,300	18,729	1,165,568
KRU Hidrodrini	7,115	124,816	19,426	151,357
KRU Mitrovica	8,145,970	104,739	3,827	8,254,536
KRU Radoniqi	1,434,996	147,619	424,864	2,007,480
KRU Bifurkacioni	67,547	61,585	19,882	149,014
KRU Hidromorava	55,331	32,262	27,397	114,990
Totali	9,986,285	1,853,052	607,028	12,446,366

Këtë vit, për dallim nga vitet e kaluara, KRU 'Mitrovica' prin me realizimin e shpenzimeve kapitale prej 8.3 mil €, vlerë e pranuar 100% nga grantet. Me këto shpenzime është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës (kryesisht me ndërtimin e fabrikës së ujit në Vushtri, projekt ky i planifikuar në vitin 2014, vendosjen e pompave dhe vendosjen e ujëmatësve).

KRU 'Hidroregjioni Jugor', dhe 'Radoniqi' kanë realizuar shpenzime kryesisht në rritje të infrastrukturës dhe jo-infrastrukturës, në prodhim dhe distribuim dhe atë në zgjerim të fabrikës së ujit, zgjerim i gypave, përtëritje dhe ndërtim të rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin e stacionit të pompave, ndërtimin e rezervuarve, instalim të ujëmatësve, pajisjet për filtrimin e ujit etj.

KRU 'Prishtina' nga vlera totale e investimeve prej rreth 603 mijë € të pranuar kryesisht nga grantet, pjesën më të madhe të tyre i ka realizuar në rritje jo-infrastrukturës në distribuim : pompa zhytëse, matësa digjital për lexim të të dhënave, instrumente për detektimin e rrjedhjeve etj, përderisa shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin

2016 kanë qenë më shumë të orientuara në projektet që kanë të bëjnë zgjerimin e kapaciteteve prodhuese: ndërtimin e fabrikës së ujit, përtëritjen e rrjetit të ujësjellësit, rehabilitim të pompave të ujit, të cilat do të ndikojnë shumë në vazhdimësinë e furnizimit me ujë, e të cilat projekte pritet se do të përfundojnë në të ardhmen, meqenëse edhe janë paraqitur si investime në vijim.

Kompania e cila ka realizuar më së paku investime në shërbimet e ujit ka qenë KRU 'Hidromorava', rreth 115 mijë Euro ose 6.72% nga ajo e planifikuar.

3.2 Shërbimet për ujëra të ndotura

3.2.1 Performanca teknike

Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Ky tregues është prezantuar për të matur bllokimet e kanalizimeve për 100 km të rrjetit të kanalizimit dhe tregon densitetin e bllokimeve, respektivisht performancën e rrjetit të kanalizimit. Në këtë rast një normë e lartë e bllokimeve mund të pasqyrojë një gjendje të dobët të rrjetit të kanalizimeve.

KRU e kanë përgjegjësinë⁵ e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit sipas kërkesave të standardeve minimale të shërbimeve në Kosovë, si dhe procedurave interne të cilat janë të bazuara në udhëzues, standarde dhe rregullore teknike të aplikueshme.




Fig. 18, Numri i bllokimeve të kanalizimit për 100km

Në nivel mesatar numri i bllokimeve 100 km/rrjet në 2016 ishte 262 kjo është rreth 50% më e ulët se sa në 2015. Kjo rënie e numrit të bllokimeve për 100 km, më tepër mund ti atribuohet mos raportimit të informacionit nga disa KRU (Hidrodrini, Mitrovica, Radoniqi, si dhe Hidromorava).

Rrjeti i kanalizimit në vend është shumë i ngarkuar, gjithsejtë janë rreth 2,300 km rrjeti kanalizimit për të ju shërbyer rreth 257 mijë lidhjeve, më shërbime, kjo d.m.th. se ka një dendësi rreth 11 mijë lidhje /100 km. Marrë parasysh se sistemi i kanalizimit në shumicën e zonave të shërbyera nga KRU nuk është shumë i zhvilluar dhe në të shumtën e rasteve nuk është i ndarë nga sistemi i kanalizimit të ujërave atmosferike, problemet rreth bllokimeve janë të mëdha.

⁵ www.arru-rks.org/Legislation/Rregullorja_02_2016_Shq.pdf, Rregullorja për standardet minimale të shërbimit të ujit në Kosovë kërkon nga KRU

- Të zhvillojë dhe implementojë një program për të pastruar gypat e rrjetit të kanalizimit. së paku një herë në pesë (5) vjet., si dhe
- Të zhvillojë dhe implementojë një program për të inspektuar, së paku një herë në dy (2) vjet të bëhet riparimi i tyre varësisht prej nevojës.

Bllokimet gjithashtu mund të tregojnë praktika të këqija të përdorimit (të tilla si hedhja e mbeturinave të ngurta në puseta) dhe gjithashtu mbingarkesa e rrjetit. Por si faktor kyç padyshim është neglizhenca dhe mirëmbajtja jo adekuate e sistemit të kanalizimit. Sido që të jetë përfundimet e nxjerra nga analiza e këtij treguesi duhet të jenë të përmbytura, meqenëse nga ana e ARRU, besueshmëria e të dhënave mbi shifrat e raportuara të bllokimeve janë konsideruar si jo të plota.

3.2.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është e definuar si përqindja e popullsisë, brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura.




Fig. 19, Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të ndotura

Siç tregohet në fig.19, ka pasur një rritje prej 4% në mbulimin mesatar të popullatës me shërbime të ujërave të ndotura.

Norma aktuale e sektorit është në nivelin prej 69%.

Progres në qasje të popullatës në shërbimin e ujërave të ndotura ka pasur po thuajse tek të gjitha KRU, megjithëse përmirësim më i ndjeshëm është shënuar në zonën e shërbimit nga KRU 'Radoniqi' (11%), si dhe dy kompanive të tjera, 'Prishtina' dhe 'Hidromorava' me nga 7%.

KRU (Hidrodrini, Mitrovica, Hidromorava, si dhe Hidroregjioni Jugor), kanë mbulueshmëri të zonës së tyre respektive me sistem të kanalizimit dukshëm nën mesatare të sektorit, ndonëse brengosëse vazhdon të mbetet gjendja në KRU 'Hidrodrini' e cila mbulon vetëm 39% të popullatës me këtë shërbim.

Ankesat

Treguesi në vijim paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i adresojnë tek kompanitë e tyre, në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura (kanalizimit).




Fig. 20, Ankesat për shërbimet e ujërave të ndotura

Numri i ankesave të konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura në 2016 është 5257 sish, në të dyja aspektet (ankesa teknike dhe komerciale), prej të cilave vetëm rreth 4% janë ankesa komerciale.

Nga fig. 20 shohim se kemi një disproporcion apo edhe mos raportim të ankesave nga shërbimi i ujërave të ndotura gjatë kësaj periudhe (2015-2016). Kjo për faktin se shumica e KRU nuk kanë arritur të bëjnë regjistrimin dhe raportimin e ankesave sipas shërbimeve.

Përderisa tek KRU 'Prishtina', ankesa komerciale, nuk mbahen si të ndara por raportohen, së bashku me ankesat e furnizimit me ujësjellës, tek KRU 'Bifurkacioni', ankesat teknike nga shërbimi teknik nuk raportohen dhe si të tilla regjistrohen në sistemin e informacionit të Kompanisë.

Në KRU 'Mitrovica' ankesat në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura 2016 nuk janë përditësuar dhe raportuar nga kjo kompani.

KRU duhet ti trajtojnë ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura dhe si të tilla të raportohen sipas kërkesave dhe specifikave të ARRU.

3.2.3 Performanca financiare⁶

Në këtë nën-seksion të raportit janë vlerësuar treguesit financiar, përmes të cilëve është pasqyruar qëndrueshmëria financiare e KRU, siç janë: shitjet, kostot operative dhe kapitale për shërbimin e ujërave të ndotura.

Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (EUR)

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor 2015-2017.




Fig.21. Shitjet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Në performancën jo të mirë të shitjeve aktuale të ujit, krahasuar me shitjet e planifikuara në nivel të sektorit, ka ndikuar që edhe shitjet aktuale në shërbimet e ujërave të ndotura të jenë nën nivelin e vlerës së planifikuar pasi që kjo e dhënë është drejtpërdrejtë e lidhur me volumet e shitjeve të ujit.

Shumica KRU nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit 2016, në përjashtim të KRU 'Hidromorava' dhe 'Radonqi', të cilat madje i kanë tejkaluar ato për 15% (Hidromorava), dhe 13%(Radonqi).

Caku i arritur për 2016 në nivel të sektorit është 95%, dhe është më i lartë për 4% nga ajo që ishte në vitin 2015.

Këtë vit KRU 'Hidromorava' ka arritur përqindjen më të lartë në realizimin e shitjeve të planifikuara, krahasuar me kompanitë e tjera dhe atë me 15%. Gjithashtu kjo kompani ka arrit që ta këtë edhe përmirësimin më të lartë krahasuar me vitin 2015 për 11% .

⁶ Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujësjellës të gjitha vlerat e shprehura në euro, janë të rregulluara sipas çmimeve bazë për vitin 2016. Viti 2014 është viti bazë i procesit tarifor (2015-2017)

Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura gjatë 2016 në raport me 2015




Fig.22, Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2016 në raport me vitin 2015

Figura më lartë tregon trendet e vlerës së shitjeve të realizuara gjatë periudhës raportuese 2016 në raport me vitin 2015, nga e cila vërehet së pesë nga shtatë KRU kanë shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015, në përjashtim të KRU “Bifurkacioni” dhe “KRU “Radoniqi”.

KRU ‘Hidromorava’ është kompania që ka realizuar shitjet më të larta në vitin 2016 me 7.44% në raport me vitin 2015, rezultat i të cilës ka qenë rritja e numrit të konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura për 22%, duke ndikuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike për 5%.

Në vlerë absolute shitjet në nivel sektori në 2016 janë për 2.68% më të larta se sa në vitin 2015.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Nënkupton shpenzimet totale operative për ujëra të ndotura, përfshirë mirëmbajtjen kapitale të ujërave të ndotura në raport me ekuivalentët e konsumatorëve shtëpiak për vit⁷.




Fig.23, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura

⁷ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definojnë si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në nivel të sektorit në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 ka qenë më e ulët për 0.71⁸ €/m³ ose 13%.

Të gjitha kompanitë në vitin 2016, në përjashtim të KRU “Bifurkacioni”, kanë treguar trende pozitive në treguesin e koston për njësi të ujërave të ndotura. Zvogëlimi i kostove për njësi i shërbimeve të ujërave të ndotura i atribuohet zvogëlimit të dukshëm të shpenzimeve operative për shërbimin e ujërave të ndotura dhe shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale për këtë shërbim.

Koston më të ulët në këtë tregues e ka KRU ‘Prishtina’, me 1.33 €/kons, me një përmirësim prej 0.32 €/kons krahasuar me vitin paraprak..

Përmirësimin më të lartë në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 e ka arritur KRU “Mitrovica”, me një rënie prej 7.97, rezultat i të cilës ka qenë zvogëlimi i shpenzimeve operative në shërbimin e ujërave të ndotura prej 45%, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura ende mbesin shumë më të ulëta krahasuar me kostot e furnizimit me ujë, meqenëse ende nuk janë futur në përdorim impiantet për trajtimin e ujërave të zeza.

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar ne raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura është po ashtu një tregues i rëndësishëm financiar, i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilit matet performanca e ujërave të ndotura.

Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak⁹) dhe koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).




Fig. 24, Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(€)

⁸ Kostoja për njësi e vitit 2015 është e rregulluar me normën të inflacionit

⁹ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definojnë si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

Kostot për njësi të realizuara në raport me ato të planifikuara që rrjedhin nga rishikimi tarifar 2015-2017 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2014), gati të të gjitha KRU ishin më të ulëta, dhe kjo tregon efikasitet më të madhe se sa ishte planifikuar, për arsye se kostot e realizuar për njësi ishin më të ulëta se niveli i dëshiruar prej 90%.

KRU 'Hidroregjioni Jugor' në krahasim me kompanitë e tjera ka arritur përqindjen më të lartë të realizimit nga caku i planifikuar dhe kjo nuk tregon performancë të mirë, për arsye se ka tejkaluar shpenzimet operative për 196% , duke mos realizuar as 2% të shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale.

Në nivel të sektorit përmbushja e kostove për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në 2016 është në nivelin prej 53%.

Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2016.




Fig. 25, Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planifikimet(%)

Edhe te shërbimi me ujëra të ndotura, njëjtë sikur te shërbimi me ujësjellës, kompanitë për vitin 2016 kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 9 milion euro për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale, e të cilat janë parapa të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur dhe atë prej 338 mijë euro ose 4% nga ajo që ishte planifikuar. Në realitet shpenzimet e realizuara sipas planit të biznesit për vitin 2016 ishin në nivelin prej 1%.

Për dallim nga shërbimet e ujësjellësit tek ujërat e ndotura, shumica e investimeve të realizuara janë nga të hyrat vetanake dhe atë rreth 252 mijë euro apo 75%, ndërsa pjesa tjetër janë nga grantet rreth 87 mijë euro .

Për vitin 2016 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzohen rreth 1.1 milion euro, të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, por kompanitë për vitin 2016 sipas planit kanë realizuar vetëm 9% nga ajo që ishte e planifikuar.

Tabela 4, Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të ndotura

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2016

KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
Prishtina	133,636	0	0	2,873	136,509
Hidroregjioni Jugor	0	0	0	2,749	2,749
Hidrodrini	87,349	0	0	1,580	88,929
Mitrovica	0	0	0	426	426
Radoniqi	100,068	0	0	2,094	102,162
Bifurkacioni	150	0	0	4,970	5,120
Hidromorava	0	0	0	2,062	2,062
Totali	321,203	0	0	16,754	337,957

Tek investimet në shërbimet e ujërave të ndotura prinë KRU 'Prishtina' me realizimin e investimeve prej 40%, të shumës totale të investimeve (337,957) dhe e cila përqindje është realizuar kryesisht në rritje të jo infrastrukturës së grumbullimit të ujërave të ndotura.

KRU 'Hidroregjioni Jugor' është një ndër kompanitë që ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura, si në rritje dhe rehabilitim të rrjetit ashtu edhe në ndërtimin e Impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, e të cilat nuk ka arritur as 0.05% (0.043%) të tyre ti realizoj dhe atë vetëm në aktivitetet biznesore.

3.3 Performanca financiare e KRU

Arkëtimi i të ardhurave

Në vijim është paraqitur performanca e kompanive në treguesin shkalla e arkëtimit për vitin 2016 krahasuar me 2015, i paraqitur si raporti në mes arkëtimit të keshit ndaj faturimit për shërbimet e ofruara të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (faturimi për tarifën fikse, volumetrike të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura).




Fig. 26, Arkëtimin i të ardhurave/faturimit (përfshirë të ardhurat e tjera operative)

Siç vërehet edhe nga figura 26 në vitin 2016 në të gjitha kompanitë kemi pasur përmirësim të shkallës së arkëtimit për faturat e shërbimit të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, e të cilat pastaj kanë ndikuar që edhe në nivel të sektorit të kemi një përmirësim të lartë krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 12%, nga 74% sa ishte në vitin 2015, në 86% në 2016.

KRU 'Radoniq' prinë me % më të lartë të shkallës së inkasimit në krahasim me kompanitë tjera, përderisa progresin më të lartë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Prishtina' me një ngritje prej 17%, krahasuar me vitin paraprak, rezultat i të cilës ka qenë ndërmarrja e disa aktiviteteve nga kompania siç janë: aplikimi i ndërprerjeve të lidhjeve të shërbimit, fshirja e borxheve bazuar në Ligjin për faljen e borxheve (konsumatorët këtë të drejtë mund ta realizojnë deri më 1 shtator 2017), riprogramimi i borxheve me këste, puna e vazhdueshme me përmbarues etj.

Performancë e dobët edhe këtë vit mbetet te KRU "Mitrovica" në nivelin prej 59% edhe pse krahasuar me vitin paraprak ka shënuar një ngritje prej 3%, rezultat i të cilës është rritja e të ardhurave të arkëtuara, përkundër rritjes së faturimit për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Objektivat rregullatore të dakorduara me ofruesit e shërbimeve të ujit gjatë procesit të rregullt tarifor për vitin 2016 në shkallën e arkëtimit, si në nivel të sektorit ashtu edhe tek të gjitha kategoritë individuale, janë arritur në raport me ato që janë planifikuar, në përjashtim të KRU "Mitrovica".

Efiçenca e arkëtimit në kategorinë e konsumatorëve të amvisërisë vazhdon të jetë e dobët gati të të gjitha kompanitë, në përjashtim të KRU 'Radoniq', e cila tash e sa vite mban rekordin në këtë kategori me 93%, e përcjellur pastaj nga KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 88%.

Tabela 5, Performanca aktuale dhe e planifikuar e arkëtimit të të ardhurave për vitin 2016

Kategoria e Konsumatorëve	KRU Prishtina		KRU Hidroregjioni Jugor		KRU-Hidrodrini		KRU Mitrovica		KRU Radoniq		KRU Bifurkacioni		KRU Hidromorava		Nivel sektori	
	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.	Real.	Plan.
Amvisëri	87%	74%	88%	74%	77%	70%	50%	57%	93%	74%	79%	68%	78%	74%	71%	82%
Komercial-Industrial	103%	90%	64%	91%	82%	90%	117%	97%	92%	92%	92%	92%	89%	95%	81%	94%
Institucione	99%	96%	119%	97%	79%	98%	69%	100%	115%	97%	89%	95%	98%	96%	97%	97%
Totali	92%	80%	87%	80%	78%	77%	59%	67%	95%	78%	82%	73%	82%	79%	86%	78%

Kthimi në Kapital

Është i definuar si kthimi në bazën rregullatore të aseteve, i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimet e shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Kthimi në kapital është i nevojshëm për të siguruar besimin e investorëve në sektorë, nëse kompanitë duan që të tërheqin financime për përmirësimin e aseteve në mënyrë që të përmbushin përmirësimin e nevojshëm të nivelit të shërbimit.

Baza rregullatore e aseteve (BRRA) mbi të cilën është përcaktuar kthimi në kapital, është përcaktuar në vitin 2008 që nga procesi tarifar (2009-2011), ka filluar me 1 Janar 2009 me bazën rregullatore të aseteve (BRA) për secilën prej kompanive të ujit, duke përdorur vlerën e përcaktuar të aseteve prej 200€ për konsumatorët e shërbimit të furnizimit me ujësjellës dhe 100€ për konsumatorët e ujërave të ndotura.

Norma reale e kthimit në kapital është e bazuar në praktikën e mira të vendeve të Evropës Perëndimore, dhe tek ne për procesin tarifar (2015-2017), kemi llogaritur që kjo të jetë 4% si shumë e kalkuluar para normës së inflacionit.




Fig.27, Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka pasur përmirësim në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 dhe atë për 0.7%.

Vetëm dy KRU (Bifurkacioni dhe Hidroregjioni Jugor) kanë pasur kthime negative pasi që nuk kanë arritur me të hyrat e tyre të mbulojnë shpenzimet e larta operative, përfshirë provizionimin e borxheve të këqija dhe mirëmbajtjen kapitale.

Përmirësimin më të lartë në vitin 2016 tek norma e kthimit e ka arrit KRU 'Mitrovica' me 13%, nga -11% sa ishte në vitin 2015, në 1.3% në vitin 2016. Ky ndryshim kaq i lartë, përkundër zvogëlimit të shpenzimeve që ka realizuar kjo kompani në krahasim me vitin paraprak, mund të dedikohet kryesisht ngritjes së të hyrave nga faturimi i rregullt, duke përfshirë edhe subvencionin të cilin e ka pranuar kjo kompani.

3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

Këtë vit ARRU ka vendosur që të bëhen disa ndryshime në skemën e vlerësimit të performancës, skemës aktuale prej 11 (njëmbëdhjetë) treguesve kyç të performancës i shtohen edhe dy tregues (uji i pa faturuar dhe raportim rregullator). Konform këtyre ndryshimeve është rishikuar pesha e treguesve në tërësi, si dhe janë vendosur kriteret e vlerësimit për këta dy tregues. Duke marrë parasysh se sfida e zvogëlimit të ujit të pa faturuar dhe domosdoshmëria për përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit (besueshmërisë) së të dhënave të raportuara nga KRU, çështje të cilat janë kërkuar dhe janë adresuar gjithnjë e më tepër nga të gjitha palët e interesit dhe KRU. ARRU konsideron se këto ndryshime në skemën e matjes së performancës do të jetë një nxitje shtesë për KRU, që ato të jenë më proaktive në drejtim të zvogëlimit të UPF, përmirësimit të besueshmërisë së të dhënave si dhe performancës në përgjithësi.

Në baze të analizave të bëra, këto ndryshime kanë impakt të konsiderueshëm në rezultatin e përgjithshëm dhe rangimin përfundimtar të KRU, sepse është ulur pesha e dy treguesve (cilësisë së ujit dhe disponueshmërisë), të cilët aktualisht kanë një nivel të lartë të përmbushjes së objektivave dhe kemi vendosur dy tregues të lidhur me humbjen e ujit dhe besueshmërinë e të dhënave, të cilët lënë shumë vend për tu dëshiruar, sidomos treguesi i UPF është në nivel shumë të ultë dhe larg objektivës së pranueshme.

Megenëse vlerësimi i performancës sipas strukturës së re do të zbatohet duke filluar nga viti 2017, dhe duke e parë të arsyeshme një shkëputje nga vlerësimi sipas skemës së vjetër, ARRU ka vendosur që këtë vit mos të bëjë vlerësimin e performancës së përgjithshme të KRU.

Tabela 6, skema matjes së performancës – 2017, treguesit kyç të performancës dhe pesha e tyre¹⁰.

Grupi	Njësia matëse e performancës	Koeficienti i nën-grupit		Koeficienti i Grupit	
Ujë	Cilësia e ujit të pijëshëm	25%	100%	45%	100%
	Presioni	5%			
	Disponueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime	20%			
	Efiçenca e kostos	10%			
	Uji i Pa Faturuar	20%			
Ujëra të zeza	Cilësia e shkarkimeve	20%	100%	35%	
	Besueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime	50%			
	Efiçenca e kostos	10%			
Raportim rregullator	Piket (besueshmëria) e përcaktuar prej Auditimit	5%		5%	
Financiar komercial /	Profitabilitet	5%		15%	
	Efiçenca komerciale	10%			

¹⁰ Kriteret, definicionet, koeficienti dhe kalkulimet për matjen e performancës, përfshirë edhe treguesit, Uji i pa faturuar dhe Raportim rregullator janë dhënë në shtojca 2, definicionet dhe arsyeshmeria.

PJESA B

PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT

4. PERFORMANCA E SEKTORIT

Kjo pjesë e raportit ofron analizë të performancës teknike dhe financiare në nivel të përgjithshëm të sektorit, siç janë vlerat sasiore të prodhimit të ujit, shitjeve, si dhe UPFmbi mbulueshmerinë me shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura. Gjithashtu ofron analiza mbi trendet e realizimit të të ardhurave të planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar dhe realizimit të investimeve kapitale, për periudhën 5 vjeçare (2012-2016)

4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF

Fig. 28, pasqyron vëllimin e ujit të trajtuar dhe për të shpërndarë në një rrjet. Shifrat e prodhimit të ujit po ashtu mund të shikohen në këtë fig. edhe në raport me ujin e faturuar, si dhe humbjet e ujit (UPF).




Figura 28, Vlerat sasiore të prodhimit të ujit, shitjeve dhe UPF-së

Ka pasur një rritje të vazhdueshme të prodhimit të ujit, duke ju përgjigjur kërkesave për furnizim të qëndrueshëm të popullatës. Ky trend që ndërprerë (fundi i vitit - 2013- dhe gjashtë muji i parë-2014) për shkakun e thatësisë ekstreme e cila ishte në Kosovë, ku në mënyrë emergjente ishin atakuar popullata e furnizuar nga KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Hidromorava'. Në vitin 2016, nga 7 (shtatë) KRU, janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët e tyre një total prej rreth 143.7 milion m3 ujë i pijshëm. Kjo është e barabartë me 256 (litër/banor/ditë)

Rritja më e madhe e prodhimit të ujit ka ndodhur në KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina', marrë parasysh se janë dy kompani të cilat kanë pasur reduktime më të mëdha të furnizimit me ujë. Natyrisht edhe kërkesa për ujë ka qenë e madhe, tani më KRU 'Mitrovica', ka rritur dukshëm kapacitetet e saja prodhuese me hyrjen në funksion të dy fabrikave të reja (Shipol dhe Balincë), përderisa edhe KRU 'Prishtina' ka shfrytëzuar në mënyrë me racionale mundësitë prodhuese të kapaciteteve të saja ekzistuese.

KRU 'Prishtina' ka përfunduar dhe ka lëshuar në prodhim Fabrikën e re në Shkabaj (Mars-2017), e cila me kapacitet të plotë do të prodhojë shtesë edhe 700 litra ujë për sekondë.

Me rritjen e prodhimit të ujit është rritur edhe vëllimi i ujit të pa faturuar, dhe në vitin 2016, kjo vlerë është mjaft e lartë, Rreth 81.7 milion m3 (57%) është uji i pafaturuar i cili nuk sjell të ardhura për kompanitë, për më tepër krijon shpenzime, si dhe deficite në furnizim të rregullt të popullatës. Trendi i rritjes së ujit të prodhuar nuk është përcjellur me trendin e njëjtë të ujit të faturuar (si rezultat vlerat sasiore të UPF janë rritur apo zvogëluar në funksion të kësaj). Vetëm për vitin 2016 mbi 4.4 milion m3 apo 1% është rritur UPF.

Uji i pa faturuar dhe i humbur: përmes rrjedhjeve, lidhjeve të paligjshme, pajisjeve matëse me të meta ose konsumimit të paregjistruar, vazhdon të jetë një shqetësim për sektorin dhe është duke shkaktuar humbje të mëdha të të ardhurave, rritje të shpenzimeve operative dhe kapitale, si dhe recesione në furnizim me ujë.

Performanca e dobët e infrastrukturës dhe matja jo e plotë e ujit të shfrytëzuar nga konsumatorët, janë dy fusha, ku nga KRU kërkohet rritje e investimeve kapitale për ta kthyer performancën e duhur te rrjeti distributiv.

Me efikasitet të mirë operativ dhe reduktim të UPF, rritja e prodhimit të ujit tani e tutje duhet të jetë e nevojshme vetëm me një rritje të bazës së konsumatorëve dhe përmirësim të furnizimit me ujë në disa prej KRU, të cilat ende mund të kenë kapacitete të kufizuara të prodhimit apo edhe resurseve ujore.

4.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe ujëra të ndotura

Paraqet raportin e popullsisë vendore me qasje të sigurt dhe të besueshme në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit të ofruar nga KRU-të.




Figura 29, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe ujëra të ndotura

Në fig.29, janë dhënë trendet e progresit të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, përgjatë katër viteve të fundit (2012-2016).

Në zonën e shërbimeve të KRU, vlerësohet se jetojnë një popullatë prej 1.7 milion njerëz, prej të cilëve rreth 1,5 milion njerëz apo 91%, marrin shërbime të sigurta të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullatës vendore llogaritet të jetë kryesisht në zonat rurale të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo edhe sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ana e KRU. Me shërbime të ujërave të ndotura janë rreth 1.2 milion njerëz apo 70%.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve është 318,324 është rritur në 2016 me 17,323 nga periudha e mëparshme raportuese. Konsumatorët shtëpiak janë rritur për 15,970 përderisa ata jo shtëpiak (komercial-Industrial dhe institucional) janë rritur për 1,353 sish.

Tek mbulueshmëria me shërbime ka ende potencial të çartë për përmirësim. KRU, duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të investuar në zhvillimin e infrastrukturës dhe sistemeve të tyre në furnizimin me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura, në mënyrë që jo vetëm të garantojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe operative, por edhe përdorimin efektiv të shërbimeve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe shëndetin e përgjithshëm publik.

4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Qarkullimi nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Figura 30, tregon efikasitetin mesatar të qarkullimit dhe inkasimit gjatë 5 viteve, dhe jep një pasqyrë më të qartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.




Figura 30, Shumat monetare për faturimin dhe arkëtimin aktual

Figura e mësipërme paraqet performancën e të ardhurave në vlerë monetare në nivel të sektorit gjatë 5 viteve të fundit (2012-2016). Në përgjithësi KRU janë duke përmirësuar efikasitetin e faturimit. Vlen të përmendet se edhe pse përmirësimi është gradual, me rëndësi të veçantë është se ai është i qëndrueshëm.

Efienca e Qarkullimit¹¹, në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2016, ka shënuar një përmirësim të lehtë, dhe atë për 747 mijë € apo shprehur në përqindje për 2.4% në raport me vitin 2015. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet zgjerimit të bazës së konsumatorëve vit pas viti, e më pas edhe ngritjes së efikasitetit të të ardhurave nga faturimi.

Për dallim nga Efienca e Qarkullimit, Efienca e arkëtimit¹², në vitin 2016 ka shënuar përmirësim dukshëm më të lartë krahasuar me vitin 2015 dhe atë prej 4,4 milion€, apo shprehur në përqindje për 18%.

Shkalla e arkëtimit në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2016 ishte 86% apo 12% më e lartë krahasuar me vitin 2015, përderisa krahasuar me vitin 2012 shkalla e arkëtimit është me e lartë për 16%.

¹¹ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative,

¹² Keshi ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative.

Tabela 7. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2012	29,111,469.23	20,609,696.24	71%
2013	29,587,834.95	21,134,227.62	71%
2014	29,296,792.70	21,890,722.67	75%
2015	31,752,576.36	23,691,351.14	75%
2016	32,499,788.67	28,071,671.01	86%

Niveli prej 86% i Efijencës së arkëtimit është mesatarisht i kënaqur, meqenëse ende 14% e borxheve nga konsumatorët, mbetet pa u inkasuar, edhe pse kompanitë janë përpjekur që përmes aplikimit të ndërprerjeve të shërbimeve të ujit, fshirjes së borxheve të vjetra dhe adresimit të mbledhjes së borxheve përmes përmbauesve privat, riprogramimit të borxheve, prapë nuk kanë arritur nivelin e duhur.

4.4 Investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujësjellës dhe ujëra të ndotura

Ky seksion paraqet analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit taritor (2012-2014) i cili ka përfunduar dhe procesit aktual (2015-2017) për vitet 2015 dhe 2016.

Është e qartë se financimi drejt sektorit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ka nevojë për mbështetje dhe përpjekje të bashkërenduara nga akterë të ndryshëm. Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime.

Nga të gjitha KRU, pritet që të realizojnë investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujësjellës dhe në shërbimin e ujërave të ndotura dhe nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare taritore (2015-2017), prej afro 137 milion euro, me një ndarje prej përafërsisht me 2/3 në furnizim me ujësjellës dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të ndotura. Nga mjetet vetanake të KRU është planifikuar të investohen rreth 14 milion euro shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura).

Tabela 8. Investimet kapitale 2012-2016

Vlera totale e shpenzimeve kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura					
Kompania	2012	2013	2014	2015	2016
KRU 'Prishtina'	5,079,692.45	9,027,944.72	1,592,704.13	964,011	739,930
KRU 'Hidroregjioni Jugor'	3,388,492.59	1,552,776.75	909,195.35	1,154,620	1,168,317
KRU 'Hidrodrini'	4,742,892.56	901,564.07	802,008.43	2,034,939	240,286
KRU 'Mitrovica'	21,850.82	2,060,992.78	0.00	-	8,254,962
KRU 'Radoniqi'	397,359.49	1,348,647.11	1,166,757.54	1,310,426	2,109,642
KRU 'Bifurkacioni'	702,391.82	58,461.05	3,060,203.32	279,182	154,134
KRU 'Hidromorava'	1,367,079.59	32,350.48	1,971,970.76	204,840	117,052
Totali	15,699,759.32	14,982,736.97	9,502,839.53	5,948,018	12,784,324

Vlera e investimeve përgjatë këtyre 5 viteve ka qenë rreth 59 milion euro, mjete të investuara kryesisht nga donatorët, si dhe një pjesë e vogël nga KRU. Në raport me vlerën e planifikuar realizimi i investimeve arrin në nivelin prej 31%.

Nga shuma e përgjithshme gjatë këtyre 5 viteve rreth 17.4 milion euro janë realizuar nga KRU 'Prishtina', përderisa me pak shpenzime kapitale janë realizuar në KRU "Hidromorava"(3.7 milion euro).

Mungesa e realizimit të investimeve të parapara sipas lartësisë dhe dinamikës së planifikuar, qoftë nga mjetet vetanake qoftë me mjetet financiare nga donatorët, nuk do të sjellë përmirësimet e planifikuara në veçanti, do të ketë ndikim në mos mirëmbajtjen e duhur dhe rritjen e aseteve të cilat janë parakusht për ofrimin e shërbimeve të mira dhe të qëndrueshme.

PJESA C

PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË (NPH IBER-LEPENCI)

5. PERFORMANCA E NHE 'Ibër Lepenci'

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Ibër Lepenci' sh. a. Prishtinë e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj. O. 'Drenas'.

Performanca e NHE 'Ibër Lepenci' me të dhëna statistikore dhe treguesit kryesorë të performancës në vitin 2016 në raport me vitin 2015 është përmbledhur në Tabelën 9 dhe 10

Tabela 9, Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci' sh. a. Prishtinë

Të dhënat statistikore për 2016 / 2015	2015	2016
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	23,589,360	24,240,235
Faturimi për ujin me shumicë (€)	489,595	539,543
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	93,268	239,014
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	450,698	665,709
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	33	39

Meqenëse natyra e shërbimeve të ujit me shumicë është më ndryshe nga aktivitetet e furnizimit me ujë të pijshëm, mundësia e vlerësimit të performancës është e kufizuar vetëm në disa tregues financiar.

Në tabelën 10 është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015.

Tabela 10, Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2015	2016
Shkalla e arkëtimit	19%	44%
Norma e punës	1.09	0.81
Norma e mbulimit të punës	0.21	0.36
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.02	0.03

Siç po vërehet edhe nga tabela dy nga katër tregues financiar të kësaj kompanie kanë shënuar progres në vitin 2016 në raport me vitin 2015.

Shkalla e arkëtimit në vitin 2016 është ngritur nga 19% në 44%, dhe kjo ka ndodh si rezultat i arkëtimit nga KRU 'Prishtina' prej 100%, përderisa nga KRU 'Mitrovica' nuk ka arrit që ti arkëtoj as 33% të shumës së faturuar.

Rritja e shkallës së inkasimit ka ndikuar që edhe norma e mbulimit të punës të jetë më e lartë krahasuar me vitin 2015 nga 0.21 në 0.36, nivel ky i cili ende mbetet në nivelin e dëshiruar për ti mbuluar shpenzimet e krijuara në këtë vit.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2016 po ashtu kanë treguar performancë jo të mirë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve operative prej 48%, përkundër rritjes së vëllimit të ujit me shumicë të faturuar (m3) për 3%.

PJESA D

AKTIVITETET E KKK

6. AKTIVITETET E KKK

Janë shtatë Komisione Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) të themeluara nga ARRU, me qëllim të trajtimit të:

- Ankesave të konsumatorëve për të cilat konsumatori nuk ka qenë i kënaqur me përgjigjen e dhënë nga ofruesi i tyre i shërbimeve,
- Këshillimit të Autoritetit për çështjet e caktuara rregullatore që prekin interesin e konsumatorëve (ankesat tarifave, standardet e shërbimit, etj.).

Në mbështetje të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU në bashkëpunim me komunat përkatëse ka zgjedhur gjithsej 32, gjegjësisht nga 1 (një) përfaqësues të tyre në KKK, përgjegjës për regjionin e tyre.

Edhe gjatë vitit 2016, KKK kanë vazhduar punën në shumë aktivitete: janë mbajtur 78 takime në të gjitha rajonet për çdo muaj, janë shqyrtuar dhe është vendosur për ankesat e konsumatorëve, janë konsultuar për çështje të ndryshme për nga aspekti ligjor: hartimin e akteve nënligjore të Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, Shqyrtimi i informacionit dhe analizimi i procedurave lidhur me shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, Informacion lidhur me lidhjen e Kontratave të Shërbimit dhe leximin e ujëmatësve, Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve, ngarkesat e tarifave për ujësjellës dhe kanalizim, raportit të performancës, etj. Për më tepër anëtarët e KKK kanë qenë të kyqur edhe në Hulumtimin e opinionit të konsumatorëve për shërbime të ujit në Kosovë¹³, të realizuar nga ARRU.

Gjatë vitit 2016 në total kanë qenë 302 ankesa, të cilat janë drejtuar 7 (shtatë) rajoneve të KKK-ve nga konsumatorët e tri kategorive. Më së shumti janë ankuar konsumatorët shtëpiak (264), pastaj konsumatorë komercial-industrial (32) dhe vetëm në (5) raste janë ankuar konsumatorët institucional, si dhe një (1) kërkesë e drejtuar në adresë të gabuar.

Nga 302 ankesa të drejtuar KKK-ve, janë trajtuar si në vijim; 260 të zgjidhura, 2 njoftim për palën, 15 të palejuara, 23 si të pa afat dhe 2 lënda në gjykatë. Konsumatorët janë ankuar kryesisht për çështje financiare siç janë faturimi paushall, mbifaturim, faturimi pa ofrim të shërbimeve, mos trajtimi në faturim ndaras sipas shfrytëzuesve të shërbimeve etj.

Tabela 11. Numri i ankesave të parashtruara dhe të zgjidhura

REGJIONI	2015		2016	
	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura
KKK -Prishtinë	205	163	212	189
KKK -Mitrovicë	2	0	1	1
KKK- Pejë	0	0	0	0
KKK -Gjakovë	11	5	14	12
KKK- Prizren	6	6	6	6
KKK -Ferizaj	18	7	50	39
KKK -Gjilan	24	20	19	13
Gjithsejtë	266	201	302	260

KKK e regjionit të Prishtinës (212) si dhe në regjionin ku shtrinë shërbimin KRU 'Bifurkacioni' (50), kanë pranuar më së shumti ankesa nga konsumatorët. KKK në regjionin e Pejës, vazhdon të mos ketë asnjë ankesë të adresuar nga konsumatorët e KRU 'Hidrodrini'.

¹³ <http://www.arru-rks.org/Publications.Studimet.html>

7. SFIDAT PËR TË ARDHMËN

a) REDUKTIMI I KOSTOVE OPERATIVE

Reduktimi i UPF (Humbjet e ujit), mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor për të gjithë ofruesit e shërbimeve, pa përjashtim. Niveli prej 57% në nivel vendi, është përgjegjësi direkte e ofruesve të shërbimeve dhe për një përmirësim domethënës në këtë drejtim ato duhet të kenë një qasje më proaktive dhe strategjike, nëse dëshirohet të këtë përmirësim në këtë tregues.

Një nga investimet që çon në zvogëlimin e kostove, është zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet riparimit dhe rehabilitimit të pjesëve të këtij rrjeti. Me këtë investim rritet me shpejtësi qarkullimi i parave. Arsyeja është e qartë sepse këto janë sasi të ujit të pallogaritura, sasi e ujit të konsumuar, por të pafaturuar, ose që pjesa më e madhe e humbjeve në rrjet për arsye teknike, si rezultat i gjendjes së keqe të rrjetit të shpërndarjes së ujit. Si referencë, në vendet më të zhvilluara konsiderohet e pranueshme nëse sasia e ujit që nuk faturohet është nën nivelin 25 %, megjithatë pragu i “praktikave të mira” është edhe më i vogël.

Në vendin tonë të gjitha KRU kanë vlera shumë të larta të UPF, në rastin më të mirë KRU ‘Radoniqi’ me 47%, megjithëse disa KRU (Hidrodrini, Mitrovica) kanë performancë edhe më të keqe. Përfitimet në zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjet për këto kompani do të jenë: më pak energji, më pak punë dhe kosto shtesë që lidhen me nxjerrjen e ujit, pastrimin dhe shpërndarjen e tij, më pak kimikate për ta pastruar dhe trajtuar ujin që do të përdoret për t’u pirë. Do të përmirësohet gjendja e përgjithshme e rrjetit, kështu që do të zvogëlohet ndjeshëm numri i nyjeve në tubacion që do të prishen, duke zvogëluar të gjitha kostot që lidhen me to. Shmangen investimet e kushtueshme për rritjen e kapaciteteve prodhuese në KRU që kanë munges të furnizimit të rregullt me ujë, qoftë edhe ato stinore, apo për shkak të problemeve me infrastrukturën e ujit të pijshëm.

Përmirësimi i efijencës së energjisë, është po ashtu një nga sfidat më të ngutshme me të cilat përballen shërbimet e ujit. Më shumë se 21% për qind e kostove operative për sistemet e ujit të pijshëm në KRU, janë për energji dhe ato janë në rritje të vazhdueshme. Menaxhimi i energjisë në aspektin global është gjithashtu në qendër të përpjekjeve në të gjithë industrinë për të siguruar që ujërat dhe sistemet e ujërave të zeza të operohen në mënyrë të qëndrueshme. Integrimi i praktikave efikase të energjisë në menaxhimin e përditshëm dhe planifikimi afatgjatë në sektorin e ujit, do të ndihmojë në uljen e kostove operative, duke liruar burime të vlefshme financiare, për prioritetet e tjera. Vlerësohet se duke përfshirë praktikën e efijencës së energjisë në impiantet e tyre të ujit apo stacionet e pompimit ofruesit e shërbimeve mund të kursejnë 15 deri në 30%, të energjisë. Mundësia për përmirësimin e efijencës së energjisë nga ofruesit e shërbimeve të ujit bien në tri kategori kryesore: në burime të ujit, në procesin e trajtimit, si dhe ndërtesa administrative;

- i. përmirësimet e pajisjeve, me fokus në zëvendësimin e paisjeve të tilla si pompat dhe ventilatorët, me modele më efikase, përdorimi i sistemeve të pompimit të efektshëm (pompat, motorët, frekuencat frekvente), deponimi dhe racionalizimi i ujit për të shmangur pompimin në kohën e koston së energjisë maksimale.
- ii. modifikimet operacionale, duke reduktuar sasinë e energjisë që kërkohet për të kryer funksione specifike, siç është trajtimi i ujit të pijshëm apo ujërave të ndotura. Modifikimet operacionale zakonisht sjellin kursime më të mëdha sesa përmirësimet e pajisjeve dhe nuk kërkojnë investime kapitale ndërmarrja e aktiviteteve audituese të shpenzimit të energjisë ose Instalimi i softuerit SCADA (pajisjet monitoruese që futen në sistemin e Kontrollit të Mbikëqyrjes dhe mbajtjen e të Dhënave), për të mësuar se ku po përdoret energjia dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësimin e efikasitetit energjetik, Instalimi i pajisjeve të dezinfektimit të efektshëm,
- iii. modifikimet në ndërtesat e objekteve administrative, instalimi i ndriçimit me energji efikente, modifikimi i dritareve dhe pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes, do të ndikojnë në zvogëlimin e sasisë së energjisë së konsumuar nga objektet administrative.

Përfitimet e përmirësimit të efikasitetit të energjisë në shërbimin e furnizimit me ujë dhe objektivave tjera të KRU janë të mëdha në aspektin mjedisor dhe ekonomik.

Një kontribut në këtë drejtim ka dhënë programi i ujit të DANUBIT (DWP), përmes “Programit për Ngritjen e Kapaciteteve të Efijencës së Energjisë në Ndërmarrjet e Ujësijellës Kanalizimeve”¹⁴

b) PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE TË UJIT

Gjetjet e raportuara përmes vlersimit të performancës dhe benchmarkingut, nuk mund të konsiderohet si një fund në vetvete. Qëllimi është përmirësimi i performancës brenda secilës ndërmarrje dhe në të gjithë sektorin.

Brenda ndërmarrjeve nevojitet zhvillimi i një sistemi më efektive të menaxhimit të performancës së brendshme, po aq sa është edhe zhvillimi i infrastrukturës. Përditësimi i Bazës së të dhënave të konsumatorëve, përmirësimi i faturimit dhe arketimit, zvogëlimi i UPF, matja e ujit të konsumuar, do të përmirësojë performancën financiare dhe do të financojë disa përmirësime në standardet e shërbimeve.

Si një rrugë e mundshme për përmirësimin e performancës së KRU po shifet kontrata e performancës bazë, në mes të MZHE-së dhe të Bordit të Drejtorëve, si dhe në mes të Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit nga Kompanitë Rajonale të Ujit. Në takimin e shtatë të KNMU, janë marrë vendime konkrete në këtë drejtim, me ç’rast i rekomandohet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që të fus Marrëveshjet e Performancës ndërmjet Njësive së Politikave dhe Monitorimit për Ndërmarrjet Publike dhe Bordeve të Drejtorëve për Kompanitë Rajonale të Ujësijellës, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit. Po ashtu KNMU ka rekomanduar që Bordet e Drejtorëve obligohen të angazhohen për zvogëlimin e ujit të pa-faturuar dhe ngritjen e arkëtimit, si dhe të fusin në përdorim kontratat e përhershme të bazuara mbi performancën me menaxhmentin e KRU (Kryeshefin ekzekutiv).

c) PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Ndërmarrjet e ujit përballen me mjaft sfida. Zgjidhja e këtyre sfidave kërkon një hark kohor më të madhë se një vit. Planifikimi strategjik është një proces gjatë të cilit ndërmarrja përcakton strategjinë e saj, ose drejtimin kryesor për një periudhë disavjeçare dhe planifikon masat kryesore që duhet të merren. Keto strategji përmbajnë qëllime specifike që duhen përbushur siq janë: kërkesat për burime financiare, burimet njerëzore dhe afate kohore. Si të tilla planifikimet strategjike sigurojnë materialin bazë për planet që mbulojnë periudha kohore më të shkurtra, veçanërisht për Biznes planet vjetore.

Janë shumë faktorë të cilët tregojnë që planet strategjike shumëvjeçare janë thelbësore për ndërmarrjet e ujit: Shumë nga investimet e parashikuara kërkojnë tre ose katër vjet, disa nga ndryshimet organizative ose të tarifave kërkojnë zbatim gradual shumë vjeçar, politikat kombëtare dhe përafrimi me rregulloret e BE gjithashtu kanë një horizont kohor që shtrihet në disa vite.

Pak a shumë të gjitha ndërmarrjet e ujit në Evropën Perëndimore hartojnë planet e tyre strategjike. Kjo praktikë duhet të zbatohet dhe tek ne aq më tepër kur kjo është edhe kërkesë e specifikuar e Ligjit nr. 05/I -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Me këtë ligj kerkohet që KRU duhet të hartojnë dhe Autoriteti duhet të aprovoj dokumente strategjike vijuese: Planet e biznesit shumë vjeqare, Planet e menaxhimit të aseteve, Planet afatgjata të investimeve, Planet e menaxhimit të thatësisë, Planet e furnizimit me ujësijellës në situata të emergjencave, Rregulloret dhe procedurat interne të ofruesve të shërbimeve në lidhje me aspektet e veçanta të punës së tyre. Në disa prej të cilave me kërkesën dhe ndihmën konkrete nga ARRU dhe Qeveria e Kosovës, donatorëve, kanë përfunduar përderisa në disa nga këto dokumente strategjike janë në zhvillim e sipër.

¹⁴ DWP_EE-brochure_ALB.pdf

SHTOJCA 1 Kualiteti dhe të dhënat e detajuara të performancës

a) KUALITETI I TË DHËNAVE TË RAPORTUARA

Korniza aktuale e raportimit të performancës kërkon të dhëna të sakta dhe të besueshme. Për këtë qëllim ARRU në baza vjetore bënë auditimin/verifikimin Rregullator të të dhënave financiare dhe jo financiare, sipas një kornize e cila ka përcaktuar qartë procedurat dhe kërkesat specifike rregullatore.

Përgjegjësia për raportimin e të dhënave të besueshme, të sakta dhe në kohë, qëndron tek kompanitë, përderisa ARRU është përgjegjës për vlerësimin e të dhënave të ofruara nga kompanitë në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë së burimeve të të dhënave.

Pas verifikimit të të dhënave ARRU ka përgaditur një draft Raport të të Dhënave të Verifikuara për secilen kompani, duke ju dhënë mundësinë secilit për të rishikuar dhe komentuar mbi rezultatet e draft raporteve, para se ato të finalizohen dhe publikohen.

Auditimi i të dhënave për vitin 2016 është realizuar gjatë muajit Prill dhe Maj-2017 nga një ekip profesional nga ARRU. Në mënyrë që auditimi të jetë i krahësueshëm dhe të shërbejë për qëllime të caktuara, auditimi rregullator është përqëndruar në mënyrë specifike në:

- Analizimin dhe verifikimin e të dhënave për të siguruar që informacioni i dhënë është i plotë, i saktë dhe i besueshëm,
- Analizimin e sistemeve të informacionit për të vlerësuar se në çfarë mase ato gjenerojnë të dhëna në përputhje me përkufizimet dhe kërkesat rregullatore,
- Verifikimin nëse kompanitë kanë zhvilluar dhe janë duke zbatuar procedurat siç kërkohet nga rregullat rregullatore,
- Intervistimin e personelit përgjegjës të kompanive për të konfirmuar nëse kuptojnë osë nuk i kuptojnë plotësisht detyrimet raportuese rregullatore,
- Rezultatet e Inspektimit të matjes së ujit të përpunuar – të cilat e kanë ndihmuar ekipin e verifikimit të të dhënave, të vlerësojnë besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave për prodhimin e ujit.

Bazuar në auditimin/verifikimin e të dhënave të raportuara për vitin 2016, ne mund të konstatojmë si në vijim.

Në kontekst të saktësisë të dhënat janë gjetur kryesisht të sakta në raport me ato që janë raportuar gjatë periudhës raportuese, në disa raste është konstatuar se pasaktësia ishte për shkakun e gabimeve teknike, paqartësisë për definicionin e të dhënave, apo edhe përditësimi i mëvonshëm edhe pas përfundimit të raportimit. Në përgjithësi pasaktësia ka të bëjë më tepër me të dhënat operative, shërbimeve ndaj konsumatorëve por edhe tek disa të dhëna financiare për shkakun e kontimeve të mëvonshme në kontabilitet pas raportimit. Pasaktësia e të dhënave ka qenë përafërsisht në masë të njëjtë në të gjitha KRU, me një përjashtim tek KRU 'Mitrovica', ku pasaktësia,ka qenë më e lartë kjo edhe për faktin se ka pasur lëvizje të personave përgjegjës, si gjatë periudhës së raportimit por edhe gjatë procesit të auditimit.

Edhe më tej mbesin shqetësimet e Rregullatorit në lidhje me besueshmërinë e disa të dhënave operative (prodhimi i ujit, pronat me shtypje jo adekuate, pronat me furnizim të kufizuar), apo edhe disa të dhëna të shërbimeve ndaj konsumatorëve (ankesat e konsumatorëve, kontratat e shërbimit) të cilat jo gjithë herë janë të besueshme, si për shkakun e mos përditësimit të rregullt, ashtu edhe për shkakun e sigurisë që ofron sistemi i mbajtjes së të dhënave në formate softuerike (Excel, apo Word dokument). Në besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave po ashtu ka ndikuar edhe ndrimi i shpeshtë i stafit, i cili është angazhuar në procesin e raportimit tek disa KRU.

Më qëllim të verifikimit të matjes së ujit të përpunuar, ashtu siç është specifikuar në rregulloren për standardet minimale të shërbimeve, është zhvilluar inspektim për shtatë (7) ofruesit e shërbimeve. Ky aktivitet ka përfshirë:

- Inspektimin e të gjitha pikave të përpunimit të ujit dhe verifikimin e mënyrës së matjes.,

- Inspektimin/verifikimin e shënimeve të mbajtura dhe atyre të raportuara për përpunimin e ujit,
- Informimin rreth mënyrës së llogaritjes së ujit të përpunuar në rastet kur matësit kanë munguar ose kanë qenë jo jofunksional,

Bazuar në këtë aktivitet është vertetuar se në nivel vendi, matja e ujit të prodhuar për vitin 2016 ka qenë në normën 65%.

Pas kalimit të afatit kohor të dhënë nga ARRU për vendosjen e matësve të ujit të përpunuar në pikat ku matësit kanë munguar, është zhvilluar aktiviteti i inspektimit lidhur me verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të ARRU. Vëmendje e veçantë gjatë inspektimit verifikues i është dhënë ofruesve të shërbimeve të cilët kanë rezultuar me nivel më të dobët të matjes së ujit të përpunuar (KRU 'Radoniqi', 'Hidrodrini', dhe KRU 'Prishtina').

Si rrjedhojë e inspektimit verifikues është vërtetuar se:

- KRU 'Radoniqi' - ka vendosur matës të ujit të përpunuar në të gjitha pikat e përpunimit, me ç'rast nga 0% e matjes së ujit të përpunuar në Gusht vitit 2016 ka arritur në 100% të matjes së ujit të përpunuar nga muaji Mars 2017. Pas analizimit të të dhënave të regjistruara në matës (ARRU i ka marrë shënimet me rastin e vendosjes së matësve), është bërë krahasimi i sasisë së ujit të përpunuar për periudhën 3 mujore (Mars/Prill/Maj) mes vitit 2016 dhe 2017. Sipas kësaj analize KRU 'Radoniqi' rezulton se në tremujorin (Mars/Prill/Maj) 2017 ka prodhuar 1,2% më shumë ujë se në të njëjtën periudhë të vitit 2016.
- KRU 'Hidrodrini' - ka riparuar dhe vendosur matës të ujit të përpunuar pothuajse në të gjitha pikat e përpunimit të ujit, me ç'rast nga 20% e matjes së ujit të përpunuar në Gusht të vitit 2016, ka arritur në 92% të matjes së ujit të përpunuar nga muaji Prill 2017.
- KRU 'Prishtina' – ka vendosur matësin e ujit të përpunuar në FPU 'Badovc' me ç'rast nga 66% e matjes së ujit të përpunuar në Gusht të vitit 2016, ka arritur në 94% të matjes së ujit të përpunuar nga muaji Shkurt 2017

Aktualisht pas vendosjes së matësve, në nivel vendi, matja e ujit të përpunuar nga 65% sa ka qenë në Gusht të vitit 2016 ka arritur në 94% për vitin 2017. Llogaritja dhe vlerësimi me metoda të ndryshme (kapaciteti i pompave, i gypave etj) i sasisë së ujit të përpunuar nuk mund të jetë i besueshëm dhe ky fakt ndikon drejtpërdrejtë edhe në besueshmërinë e treguesve tjerë siq janë: humbjet e ujit, prodhimi dhe konsumi për kokë banori, kosto njësi, etj.

Të dhënat për presionin nuk janë plotësisht të besueshme në asnjë prej KRU, ato nuk kanë një sistem të instaluar për menaxhimin e presioneve, përjashtuar ndonjë zonë ku kompania zhvillon aktivitete për menaxhimin e humbjeve të ujit apo edhe rasteve në përgjigje të ndonjë ankese, baza e shënimeve (ditar, raporte pune) është e pa qëndrueshme.

Në përgjithësi të dhënat operative mbahen në dokumente raportuese, ditat pune. Të dhënat për gjatësin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në shumicën e KRU mbahen edhe në GIS, ndonese në vazhdimësi janë duke u azhurnuar. Baza e të dhënave, financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve në përgjithësi mbahet në module softuerike (navision, pronet, piano, rikont, alpha), disa prej tyre nuk kanë mundësinë e ndarjes sipas kosto qendrave apo ndarjeve në zëra të shpenzimeve e cila pastaj në mënyrë manuale bartet në formate Exceli, përderisa të dhënat për zhvlerësimin sipas kosto aktuale, të dhënat për bazën rregullatore të aseteve për ujësjellës dhe ujëra të ndotura mbahen në formate të Excelit. Në përgjithësi të dhënat financiare kanë rezultuar të jenë më të besueshme. Me qëllim të përmirësimit të saktësis dhe besueshmërisë së të dhënave, rregullatori ka sygjerruar që: të dhënat e raportuara, duhet të jenë gjithmonë të bazuara në shënimet e mbajtura në mënyrë të rregullt nga Kompania, dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna në manualët dhe udhëzuesit për raportimin e të dhënave, për t'ju shmangur diferencave të pa qëllimshme në mes të të dhënave reale me ato të raportuara.

- E dhëna operative për ujin e prodhuar (përpunuar) duhet të bazohet në sistemin e matjes përmes ujëmatësit dhe raportimit sipas udhëzimeve të dhëna në 'UDHËZUES PËR MATJEN E UJIT TË PËRPUNUAR', të hartuar dhe aprovuar nga ARRU,
- Të dhënat e tjera operative (gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, defektet në rrjet, presionet, ndërprerjet e ujit, etj.), të përditsohen dhe azhurnohen në bazën e Sistemit Informativ Gjeografik GIS,
- Matja dhe raportimi i të dhënave për humbjet e ujit: të shfrytëzohet: 'Moduli- Balanci i Ujit-WB-Easy-Calc; i percjellur nga ARRU dhe i rekomanduar edhe nga qeveria e Kosovës (KNMU),
- Të vazhdohet me ndarjen e zonave të furnizimit me zona për menaxhimin e humbjeve dhe presioneve të Ujit (DMA), si dhe vendosja e monitorimit të vazhdueshëm të presioneve dhe parametrave të tjerë të rrjetit distributiv,
- Të vazhdohet me avancimin e sistemeve softuerike të aplikueshme për të dhënat financiare, shërbimeve ndajë konsumatorëve, edhe me tej si dhe të sigurohet edhe me tej integrimi i tyre në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të informacioneve në kuadër të kompanisë.

b) TË DHËNAT E DETAJUARA TË PERFORMANCËS

Tani pas 6 viteve prej kur ARRU kishte vendosur ndryshimin rrënjësor të modelit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës për të vendosur konceptin e ri të monitorimit të performancës i cili është në përputhje me kërkesat specifike Rregullatore, mund të konstatojmë se regjimi i tanishëm i raportimit e ka mbajtur ritmin duke ju përshtatur ndryshimit të kornizës Rregullatore, sidomos futjen në përdorim të procesit tre vjeçar të rishikimit tarifor, kornizës për planifikimin e biznesit dhe kontabilitetit rregullator.

Të dhënat dhe treguesit e performancës në përdorim plotësojnë të gjitha kërkesat e matjes së mirë dhe efektive të performancës për nevoja dhe qëllime të proceseve Rregullatore, institucioneve vendore me përgjegjësi vendimmarrëse në këtë sektor, informacione të vlefshme për donatorët, konsumatorët, ofruesit e shërbimeve dhe publikun e gjerë.

Për nevoja të raportit shfrytëzohen edhe të dhëna tjera të ofruara dhe të publikuara nga institucionet përgjegjëse siç është rasti me të dhënat e raportuara nga IKSHPK (kualiteti i ujit) apo Agjencioni i Statistikave të Kosovës (shkalla e inflacionit, statistikën e popullatës dhe ekonomive familjare).

Matja e performancës përqëndrohet në: performancën e furnizimit me ujë, performancën e shërbimeve për ujëra të ndotura dhe performancën e biznesit (si një tërësi). Në krahasim me caqet e përcaktuara në biznes plane në bazë të të cilave janë përcaktuar tarifat, nivelin e përmbushjes së standardeve vendore të shërbimit, si dhe një vlerësim krahasues vit pas viti si në aspektin individual të KRU dhe në raport me njëra tjetren, vlerësimi i përgjithshëm i performancës, bazohet në masat absolute të performancës përmes treguesve relativisht të thjeshtë të pavarur nga njëri tjetri. Pra është një strukturë e përshtatshme për matjen e performancës së përgjithshme.

Për benefitet e Qeverisë së Kosovës dhe agjensive të zhvillimit, vlerësimi i performancës bëhet për sektorin si një tërësi dhe për një periudhë më të gjatë kohore, për të parë sa më qartë trendet e zhvillimit të sektorit.

Gjatë përpilimit të raportit të performancës për 2016, ARRU ka marrë parasysh vetëm të dhënat e gjetura gjatë procesit të auditimit.

Në gjithashtu rekomandojmë ndryshimet tek menaxhmenti brenda KRU, për të krijuar vetëdijen se ata, përfshirë edhe çdo zyrtarë tjetër i involvuar në procesin e raportimit, është përgjegjës për sigurimin e informacionit të besueshëm, të saktë dhe në kohë.

Statistikat e detajuara të performancës së shtatë KRU, janë të paraqitura në tabelat në vijim. Informatat e prezantuara pra, janë të bazuara në dorëzimin e rregullt të raporteve në ARRU.

- të dhënat në lidhje me statistikën e popullsisë, numrin e konsumatorëve, gjatësinë e gjypave, etj. nuk janë të dhëna të fund vitit por mesatare të vlerësuara të vitit.
- të dhënat financiare të shprehura në EUR, janë të përshtatura në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2015 e në përputhje me statistikën e publikuar të inflacionit për të mundësuar krahasimet e duhura nga viti në vit.
- të dhënat financiare janë raportuar në përputhje me, Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR), e në veçanti:
 - ✓ përcaktimi i vlerës së asetëve është bërë në bazë të Bazës Rregullatore të Asetëve,
 - ✓ mirëmbajtja kapitale është definuar si kombinim i ripërtëritjeve infrastrukturore dhe zhvlerësimit sipas kostos aktuale të asetëve jo-infrastrukturore,
 - ✓ provizionimi i borxheve të këqija (shlyerja) është definuar si dallimi në mes të faturimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga viti i kaluar,
- performanca e arkëtimit të të ardhurave është definuar si dallimi në mes të faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura (duke përjashtuar taksat e kyçjeve dhe të ardhurat tjera) dhe të ardhurat në kesh për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura (poashtu duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera).

KRU Prishtina (Prishtinë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2015	2016
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	100%	99.3%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	100%	92.5%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	130	122
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0.13%	0.12%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	10,441	28,707
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	11%	27%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	52,613	55,361
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	54%	53%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	35,002	20,694
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	36%	20%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	20,899,398	23,630,379
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	517	548
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	613	620
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	51%	53%
	Plasartitjet e gypave	Frekuenca e plasartitjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasartitjet për muaj	118	112
		Plasartitjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	83	75
		Jo-financiar (komercial)				
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	98,056	104,762
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	106%	112%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	5,617	7,796
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	777	760
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	97%	97%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	100%	100%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	457	430
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	70	21
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranura (teknike)	W.2.C.01	Nr	6,146	3,001
		Ankesat e pranura (komerciale)	W.2.C.02	Nr	2,132	4,342
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	15,560,617	15,991,355
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	81%	80%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	750,951	719,651
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	273%	783%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	4,048,894	4,486,130
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	84%	90%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	22,570	18,683
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	7,570,435	7,789,621
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	87%	89%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	4,052,243	4,443,477
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	87%	95%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.056	0.055
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.060	0.058
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.451	0.415
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	231,724	2,881
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	4%	0.06%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	1.1%	0.01%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	710,903	600,540
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	6.0%	9.06%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2015	2016
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	2,716	3,315
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	799	463
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	0
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	0
	Mbingarkimet e implantit për trajtimin e ujërave të zeza	Mbingarkimet e implantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	82,670	89,782
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	89%	96%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	6,877	7,347
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	861	742
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	0	3,627
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	700,617	714,879
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	88%	90%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	440,569	482,319
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	86%	94%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.01	EUR/m3	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.02	EUR/m3	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	1.51	1.24
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	1.65	1.33
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	6,215	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	3%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0.1%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	15,168	136,509
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	27%	237%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet		Totali i shitjeve	F.1.A.01	EUR	12,763,864	13,430,296
		Totali i shitjeve në raport me planin	F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	87%	91%
Eficienca e arkëtimit		Totali i të ardhurave të arkëtuara	F.1.B.01	EUR	9,638,404	12,406,535
		Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave	F.1.B.02	EUR	-1,792,368	612,265
		Totali i tejkallimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)	F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	84%	105%
		Totali i të ardhurave të shlyera (faturimi-inkasimi i vitit paraprak)	F.1.B.04	EUR	2,391,457	3,125,460
		Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit	F.1.B.05	% e faturimit	19%	23%
		Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin	F.1.B.06	% e faturimit	76%	92%
		Llogaritë e arkëtueshme	F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
		Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin	F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	4.80%	5,71%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
		Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2015	2016
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	92.9%	98.5%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	99.7%	94%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	35,965	37,663
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	99%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	200	100
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	1%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	200	200
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	1%	1%
Shërbyeshmëria infrastrukturore	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	10,010,227	10,025,665
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	654	629
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	655	630
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	58%	58%
	Plasirijtjet e gypave	Frekuenca e plasirijtjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasirijtjet për muaj	156	196
		Plasirijtjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	366	462
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	36,366	37,964
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	67%	69%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	1,415	1,781
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	189	91
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	95%	94%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	98%	97%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	0	1,862
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	0	199
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	878	1,420
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	510	808
Financiare						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,335,395	5,379,416
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	76%	71%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	773,761	795,034
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	243%	271%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,084,407	1,055,358
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	70%	66%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	104,899	115,740
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	1,727%	2,391%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,639,603	2,680,511
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	85%	84%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	1,023,252	1,014,339
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	81%	81%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.083	0.082
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.085	0.084
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.397	0.396
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	95,923	23,888
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	26%	0.29%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	1.4%	0.34%
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	199,534	1,141,680
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	3.5%	13%

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2016

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2015	2016
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	987	1,036
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	366	384
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	45	59
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	16.7	21.85
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A
Jo-financiar (komercial)						
Shtrirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	31,292	32,860
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	58%	59%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtrirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	1,126	2,010
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	174	78
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	0	63
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	24
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	313,912	319,249
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	91%	93%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	127,128	125,328
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	76%	76%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.01	EUR/m³	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.02	EUR/m³	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	10.65	10.19
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	10.70	10.23
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	1,125
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0.08%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0.05%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	859,163	1,624
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	15.8%	0.04%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet	Totali i shitjeve		F.1.A.01	EUR	4,103,895	4,139,428
	Totali i shitjeve në raport me planin		F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	84%	83%
Eficienca e arkëtimit	Totali i të ardhurave të arkëtuara		F.1.B.01	EUR	3,045,725	3,613,049
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave		F.1.B.02	EUR	-761,114	-358,752
	Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)		F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	80%	91%
	Totali i të ardhurave të shlyera		F.1.B.04	EUR	971,282	1,058,171
	Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit		F.1.B.05	% e faturimit	24%	26%
	Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin		F.1.B.06	% e faturimit	74%	87%
	Llogaritë e arkëtueshme		F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
	Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin		F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	-0.87%	-1.76%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
	Normat	Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
		Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidrodrini (Pejë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2015	2016
W- Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	92%	98.9%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	93%	94%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	36,908	39,107
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	100%	100%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	14	14
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	0%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	0	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	0%	0%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 për ditë	16,776,858	16,556,768
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	1,101	1,026
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	1,101	1,026
	Plasritjet e gypave	Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	66%	65%
		Frekuenca e plasaritjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasaritjet për muaj	57	158
		Plasaritjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	116	239
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	36,921	39,121
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	95%	99%
Matja e ujit	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	2,644	1,756
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	280	252
	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	95%	95%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	96%	95%
Ankesat	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	1,057	2,970
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	49	423
		Ankesat e pranura (teknike)	W.2.C.01	Nr	2,485	1,309
		Ankesat e pranura (komerciale)	W.2.C.02	Nr	68	85
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	6,766,061	7,048,032
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	89%	88%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	186,505	178,891
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	63%	90%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,825,801	1,772,266
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	104%	100%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	4,763	7,769
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	24%	78%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,091,660	2,186,374
